



DENISA PAHO

HABIT ME PIKTURËN E SAJ
MBARË ELITËN SHQIPTARE

- ❁ *E LARGËT... por e VËRTETË*
- ❁ *A JEMI SËRISH
PO AQ VËLLEZËR...?!*
- ❁ *LINDIM TË BARABARTË,
...marrim rrugëtime
TË NDRYSHME...*

SUPLEMENT

Palestina plus

Udhëzim prej Zotit

*Kur do Zoti, dhe të udhëzon
e ka të tjerë që lë në humbje
nën gërmadha të rrënon
nën ujë, tërmet e prurje!*

*Pati popuj mëkatarë
popull si ai i Lutit
U fundosën nën gërmadha
duke mbetur vula e turpit*

*Histori mbushur me drama
ka kalaur gjithë kjo botë
që nga kohërat më të lashta
nga fillimi gjer më sot*

*që nga lindja gjer në vdekje
madje që nga barku i nënës
fati na është vënë në ndjekje
nga Bujari Fatdhënës*

*në kam folur shtrembër
është veç faji im
suksesi dhe ndihma
janë dhuratë prej Zotit tim*

*Nga: Sali Shehu
BERAT*

Këshilli i redaksisë:

Adelina Kasemi, Eriona Kodragjini, Entela Hidri,
Armida Plumbi, Enkeleda Rroshi, Edlira Dyrmishi.

Pikëpamjet e paraqitura në revistë nuk shprehin
domosdoshmërisht pikëpamjet e revistës.

Mirëpresim sugjerimet tuaja, idetë e opinionet pranë
adresës sonë:

e-mail: pertejfalës@gmail.com

Shtypi: "Ilar"

Përmbajtja

Editorial nga A. Muja	▶	4	Lindim të barabartë, ... marrim rrugëtime të ndryshme
Imazh redaksia	▶	6	Denisa Paho, habit me pikturën e saj...
Jetë paralele nga A. Muja	▶	8	Vëzhguar nën syrin blu
Seria e Profetëve nga I. Tota	▶	11	Ademi
Përtej fjalës nga Amina Ndreu	▶	14	Së bashku ... më mirë
Pasqyrë nga J. Kulla	▶	17	Jo mendja të çoroditura e shpirta të trazuar
Thesar nga A. Kurti	▶	19	Ajisa dhe Fatimja
Përreth një boshti nga E. Rroshi	▶	24	Femra, drejt civilizimit të denatyrimit
Unë pyes nga O. Heta	▶	26	Konfliktet prindër-fëmijë
Dedikim nga H. Jaho	▶	29	Si ta njoh fëmijën 3-6 vjeç?
Mjekësi profetike nga A. Plumbi	▶	31	Hixhamja
Jo vetëm kuriozitet redaksia	▶	35	Mrekullia tek deveja
Më duhet ta di nga V. Hoxha	▶	39	Acidi folik, vitamina që mund të ndryshojë jetën
Vetëm për zemrat nga E. Hidri	▶	41	Dallgët e jetës

SUPPLEMENT ▶ 44 - 56

Palestina plus

Kryeredaktore: ALBANA MUJA (CIKU)

Redaktore gjuhësore: Prof.dr. Mimoza Gjokutaj

Recensues fetar: AHMED KALAJA

Art grafika: Ornela Biti

Organ i Shoqatës Kulturore: FEMRA INVESTIM I FAMILJES
TIRANË-ALBANIA





... tani sapo ka filluar ...

*Lindim të barabartë,
... marrim rruqetime
të ndryshme...*

Bota që lind e shfaqet e madhe, thuhet se e bëjnë atë po aq dhe njerëzit e rrugëtimet e tyre; puna, zgjedhjet e mundësitë. Shekuj më parë, "njerëz të mëdhenj", janë quajtur profetët, e më pas dijetarët e shkëncëtarët, por rrethi nuk u mbyll. Ka akoma njerëz që ndjekin rrugën e tyre si vazhdim i atij rrugëtimi të gjatë që na çon drejt arenave të lumturisë.

Kështu që kur lindim, lindim të barabartë me drejtësinë e më të Drejtit, por përpjekjet për më shumë, për më mirë, për të zgjedhur apo zgjidhur, na bëjnë të ndryshëm. Ndaj edhe kjo logo me kuptim të gjithanshëm na fton ashtu sikurse edhe vitin që kaloi në projektin e madh ndërqytetas për esenë më të mirë bazuar në temën e lartpërmendur.

Kështu pas aktivitetit: "*Vendi ynë përballë sfidave*", këtë vit Departamenti i Gruas pranë KMSH-së drejtuar nga Znj. Iris Maçi, (Gjinishi) në bashkëpunim me Qendrën Kulturore "Femra investin i familjes", qendër e cila karakterizohet nga fryma e bashkëpunimit, nga fryma e nxitjes, e promovimit dhe vlerësimit të asaj çfarë sjell rinia sot, morën përsipër aktivitetin në fjalë.

Kjo temë për nga gama e gjerë e nëntemave që mbërthen, shpreson t'u japë mundësi të rejave të shprehin atë çfarë ndjejnë dhe që nuk kanë ndoshta mënyrë tjetër për ta shprehur ndryshe ashtu sikurse në një "ese artistike". Ndaj edhe rezultatet e para të këtij marshi kanë mbërritur me hapjen e siparit në qytetin e Kavajës për të vazhduar më pas në qytete të tjera

e për të mbërritur në fund në një takim të madh në kryeqytet.

Gjithnjë thuhet se provinca është aq larg nga metropoli jo vetëm gjeografikisht por edhe në çdo stil jete. Por, çdo largësi fizike dhe hendek social tashmë është shkurtuar, duke i sjellë madje në vëmendje së pari qytetet e largëta, duke nisur pikërisht me to, për të mbërritur më pas me fitueset e rretheve në Tiranë, ku i pret një festë e madhe.

Ky aktivitet që sjell në vëmendje zërat e rinj, problematikat e tyre, ndjenjat dhe përjetimet sikur i jep jetë këtij rrugëtimi, por edhe shoqërisë ku ata jetojnë e arsimohen. Është një hap ndryshe, duke i bërë edhe ato të ndjehen se janë dikushi. Ato dinë të hedhin në letër atë çfarë ndjejnë dhe dinë, të japin mendime, opinione, ndjenja e më pas të vlerësohen. Gjithashtu, kjo i bën jo vetëm adoleshente të reja problematike, jo vetëm gra shtëpiake si realitet i mugët i shoqërisë, por si realitet që di të gërshetojë mirë të tilla mundësi ku përshfaqet forca e penës, e ndjenjës, e mendimit mbi lindjen dhe rrugëtimin e tyre.


...tani sapo ka filluar... jehona e këtij rrugëtimi që zgjat dhe zgjat, duke ftuar çdo nxënëse të re apo studente si dhe grua, nënë ose jo, pa asnjë dallim, të bëhen pjesë e këtij rrugëtimi artistik me esetë e tyre rreth temës qëndrore për të qenë një ditë pjesë e përbashkët e një festimi realisht artistik ku festime të tilla i mungojnë shumë shoqërisë sonë.

Windows

**Expo
Art
Gallery**

Denisa Paho

**Kledio
Gallery**



Ish studentja e pikturës para pak kohësh habiti mbarë elitën kryeqytetase me mrekullinë e stilit të saj në pikturë. Ky ishte vlerësimi i parë nga mediat që i kushtuan rëndësi dhe hapësirë të veçantë ekspozites së saj.

E lindur në Bilisht të Korçës, ajo ka ditur të përfitojë nga qyteti i saj i lindjes mrekullitë që Zoti ia fali natyrës së qetë, duke u bërë kështu burim frymëzimi për të, hap pas hapi. Tek ajo spikat talenti i rrallë i lindur, një gjetje gati gjeniale përsa i përket stilit, ku ndërthuren aq këndshëm brendia me peisazhin. Kjo e ka shtyrë atë të prihet nga logoja shumëdimensionale: "WINDOW".

- *Dritaret janë një vazhdim i temës së diplomës - shprehet ajo. - Dritarja një përpjekje për të dualizuar ambientin jashtë dhe atë brenda. DRITARJA është ambienti më interesant në banesat tona, nga e cila hyn dhe del drita, ajo na lidh me hapësirat jashtë. Imazhin herë e shohim nga brenda-jashtë, herë nga jashtë-brenda, herë pas perdes, e cila i jep mundësi ngjyrës të dominojë, të shfaqet bindshëm e të fitojë vlera.*

Një botë e tërë ndjenjash, përjetimesh, ngeciesh, por edhe realizimesh të para nga dritarja na rikujtojnë poetë e shkrimtarë të hershëm ku DRITAREN e konsideronin simbol të vizionarit e të largpamësit. Kjo është e veçanta e Denisa Pahos. Nga ambienti i dhomës së saj të vogël ajo shikon mbrarë horizontin që shfaqet hareshëm, e ansjelltas; nga arena e madhe e natyrës jashtë arrin të shohësh brenda një guacke të vogël çfarë shfaq dhe fsheh ajo, çfarë sugjestionon ajri në të, rregulli, arredimi i hershëm e klasik, stil i "varfër apo i kamur". Realja në ngjyra, është një veçantë tjerë e stilit të saj.

Nuk i pëlqen shumë imaginata, por ajo që e nxit në natyrë dhe brendashtëpive. Çdo

gjë merr udhë me plot ngjyrë dhe ndjenjë. Ndërthurjua e traditës me modernen e ka bërë më tërheqëse pikturën e saj, e jo pa qëllim një pjesë e jorganit të vjetër thujasë 4 brezash u bë piktura që shpesh e çdokush mund ta krahasonte me ato të Van Gog-ut. Kështu vazhduan vlerësimet për pikturën e saj nga elita e kulturës dhe politikës shqiptare, duke blerë dhe shijuar në nivele habitëse pikturën e Denisa Pahos për 7 ditë rradhazi pranë Galeri Kledio - Tiranë.

Ideja e saj, por shtysa dhe përkrahja e dy pedagogëve të Arteve: Ardian Isufi dhe Ali Oseku, realizuan më së miri këtë paradë njëjavore vlerash për një grua që tashmë gëzon nder e vlerësim nga ata që dinë të vlerësojnë; një grua artiste e për më tepër besimtare myslimane.

Kështu, çdo gjë që ka nisur tashmë për të ka një kuptim të dyfishtë; *pasion* dhe *profesion*, por njëherësh dhe *falenderim* i *Krijuesit* për gjithçka i fali asaj, ku përveç talentit në pikturë gëzon edhe dy dhurata të tjera: bashkëshortin dhe djalin e saj. Piktoria, tashmë nënë, nuk i ka shpëtuar ngacmimit që sjell bota e fëmijëve ndaj edhe e kemi parë tek ka hedhur në karnavacë siluetën e djalit të saj që luan në botën e tij të madhe. Duke pasur bosht "dritaren" por edhe shumë punë të tjera "Reflektim", parësore është ngjyra e këndvështrimi, ndërsa në plan të dytë është tema.

Vlerësimet më të mëdha ajo i mori për ndjeshmërinë e ngjyrës. Ajo shprehet me bindje se e ka konceptuar çdo gjë si dhunti që ia ka dhuruar Zoti i saj dhe ndoshta ky pasion për pikturën përbën edhe një pjesë të adhurimit të saj të padiskutueshëm.

Ne presim nga Denisa të na befasojë ndoshta shumë shpejt me arritje të tjera akoma më të mëdha e më të suksesshme!

DENISA PAHO,
habit me pikturën e saj mbarë elitën shqiptare

VËZHGUAR

NËN SYRIN BLU

Veç shumë gjërash që na dërguan aq larg dhe lart, na mësuan aq shumë dhe aq mirë, përjetuam ëndrra të të tjerëve tek shqyejnë realitetin e bëhen princesha princash sykaltër sot bota e mediave trondit me tendencat e zvetënuara që përdor për realizimin e qëllimeve herë-herë të dyshimta.

nga A. Muja

Të shumtë ecën në këto dekada të frikshme por plot risi, plot vitalitet për pakëz jetë ndryshe. Bota e secilit dukej më e madhe se sa vetë Everesti gjigand. Botët janë të ndryshme, por përse u pa si më e madhja ajo botë e madhe televizive, ku dihet se jo çdokush ka mundësinë të jetojë në të!

Kjo botë televizive dashur pa dashur i bëri ca personazhe të mëdhenj, më të njohur, më të dashur e të dëshiruar.

Kështu edhe "syri blu" në një nga kanalet televizive mori nën emrin "diktat" ai që vë e vendos, vulos e nuk njolloset fjala e tij, vendimi i palëkundur, damka e tij "Vëllai i madh" vazhdon të vëzhgojë "pa leje".

Importuar nga vende të tjera evropiane, ky sy bojëqielli erdhi për të vëzhguar dhe tek ne. E me patjetër që do të vinte, ashtu siç erdhën dhe shumë importe të tjera.

Dita e parë në një vit të parë transmetimi, ishte ditë risie pa fund, me të gjitha seriozitetet që i takojnë një shfaqje publike. Tek personazhet e zgjedhura kishte spikatje karakteresh e stereotipesh, e ndër këta stereotipe dallonte pakëz qartë morali i tyre njerëzor, dinjiteti dhe personaliteti prej njeriu që njëh caqet.

Por, ishte veçse dita e parë.

Më pas syri bly, më vëzhgues se kurrë, vëzhgoi thellë në karakteret e ulëta e

perverse të personazheve, i njohu ata sa të dobët ishin me vetet e tyre dhe si çdo sy zhbirues i zbuloi ca të fshehta që nuk duhej të viheshin në pah medoemos për të qenë ky "kanali më i vëzhguar".

Syri vëzhgonte çdo gjë, madje në këtë rast edhe dëgjoi më mirë se veshët, nuhati më shumë se hundët, ndjeu më shumë se sa lëkura, se një popull që akoma nuk di të ngrrejë kulmin e shtëpisë së tij të moralit e të dinjitetit, di të ngrrejë kulme të tjera marrëzie e amorale. Dhe ashtu siç edhe pritej nga shumëkush, u kulmua një shtëpi e "pamorali". Po të dëgjonte ajo se çfarë thonë mbi të, shprehje të tilla si: "Shtëpia më e madhe në Shqipëri", "...më e vëzhguara në Shqipëri", "...më e mira..." etj. etj., mendoj se do i zinte të gjithë poshtë saj.

Nuk jam vetëm. Ka shumë të tjerë, madje nga ata që dinë më shumë, se shtëpi e madhe nuk quhet ajo që ka dhe ofron shumë dhoma apo shumë kolltuqë, perde apo tavolina luksoze, por ajo që ka njerëz të mëdhenj, dritare të mëdha komunikimi që shkëmbejnë art e kulturë. Dhe sigurisht, jo prishje e antivlerë.

Ndaj dhe në këtë shkrim edhe pse kaq prerazi, shtyhem të shkruaj për dy shtëpi ku vërtet si për koençidencë, në një të jetojnë 13-14 studente ashtu sikurse



në shtëpinë e Big Brother jetojnë po aq persona.

I vura paralel për të parë të përbashkëtat dhe dallimet mes tyre.

Po dallimet janë shumë, janë shumë.

Një vizitore e tyre na tregon për ta.

Mbresat e një takimi

Ishte një takim aq i përzemërt, ku fillimisht as që e dija shkakun e tij. Dija se do më jepej mundësia të takohesha me disa vajza besimtare që jetojnë së bashku, e deri këtu ishte një gjë e zakonshme, por nuk ishte vetëm kaq. E dija se ato studente ishin të shkëllyera dhe besimtare të denja, e kjo e fundit më kishte krijuar dëshirën për t'u takuar me to.

Kur hyra në apartamentin e tyre, më pritën si zonja të vërteta, të veshura aq bukur. E akoma më e bukur ishte mënyra e të priturit.

Nuk dija se si do rridhte programi i këtij takimi, ndaj nuk e vura re se në krye ish ulur një vajzë e veshur bukur me një fustan rozë të ëmbël dhe një shall elegant që mbulonte dekoltenën e saj.

Pasi i përshëndeta u ula. Pyeta vajzën që kisha pranë. Ishte studente e mjeksisë dhe prej saj mësova shkakun e takimit, përse ishin mbledhur këto vajza në mes të së cilave më kishin nderuar edhe mua me një miken time. Dhe ajo më shpjegoi, se shoqja e tyre, që ndanin së bashku apartamentin ishte fejuar. E urova me zemër vajzën, e më pas vajzat filluan të qerasnin. Sa këndshëm komunikonin me njëra-tjetrën. Të dukej sikur ishe në një familje me shumë motra dhe secila mendohej të rrespektonte pjesmarrëset, duke nderuar kështu "familjen" se vërtet ky apartament ishte bërë tashmë shtëpia e tyre. Ishin vajza të ardhura nga rrethe të ndryshme me kulturë dhe mentalitet të ndryshëm, por dukej se kishin gjetur një emërues të përbashkët, atë mirëkuptimin në një bashkëjetesë plot harmoni. Dhe përveç karakterit, edukatës së secilës prej tyre që sillnin nga vendet prej nga vinin, do t'i bashkonte ajo dhurata e madhe, besimi. Motoja e tyre ishte mirësjellja, mirëkuptimi e harmonia. Vetë që ti jep dhe ti plotëson vetëm besimi. Ato e kishin gjetur lumturinë,

atë lumturi shpirtërore që gëzonin e prisnin aq bukur në ditën më të gëzuar të shoqes së tyre. Dhe kjo shprehej në sytë e tyre, në këngën, në vallen që s'pushoi asnjë moment. Dukej se nuk kishin lodhje. Kishin një motiv të fortë, i gëzonte gëzimi i shoqes së tyre.

Unë kënaqesha duke parë vitalitetin e këtyre vajzave. Jam e bindur se nusja ndjehej e lumturuar duke ndjerë që shoqet i kishte kaq pranë vetes dhe gëzimit të saj. Nusja me buzëqeshjen e saj dhe sytë e saj plot shprehje falëndërimi e bëri këtë pasdite shumë të veçantë. Ishte vërtet tepër njerëzore dhe e sinqertë, një dashuri pa xhelozë e smirë pa ambicie të sëmurë që e ndeshim rëndom në jetën tonë të përditshme. E patë smirën mes rivalesh në spektaklin e syrit "blu"?!

Ne na respektuan pa masë, e këto gjëra nuk i thotë dot fjala. Në shpirt më mbushi mirësia e tyre. Ato dinin të vallëzonin bukur, të këndonin, shikoja tek shpirti i tyre rinor dëshirë për gjallëri, veshje elegante, por edhe përpjekje për dituri e arsim.

Më ra në sy edhe diçka tjetër; ato i kishin lënë vend edhe kënaqësisë së fëmijëve, të cilët vallëzonin e këndonin bashkë me to. Edhe ata e ndjenë kënaqësinë e kësaj feste, këndonin këngët e tyre dhe uronin në një farë mënyre nusen. Ishin të vegjël por të veshur bukur e plot ngjyra, me plot finesë e dliresi ku dominonte e kuqja. Njoha edhe një fëmijë që ishte shumë i shkathët, i papërmbajtur, emrin e të cilit nuk e mësova por u njoha mirë me mamin e tij, një zonjë grua e fisme.

Më pas ishte fjala e mikes së tyre, një vajze që fliste mbi rëndësinë e familjes në islam, rëndësi që po të mësohej kaq mirë shoqëria e sotme me të, do ishte gjithçka ndryshe. E dëgjova me kënaqësi. Dhe në ato çaste e parapërfytyroja se sa e sukseshme do të ishte, po të mbante ligjëratat të tilla në një auditor më të gjerë.

Ky ishte një takim pa pretendime, pa sallë të madhe, pa ftesa e kartvizita, pa orkestër, ishte gjithçka e thjeshtë por tepër njerëzore, për të cilën kemi shumë nevojë.

Aty, mjaftoi vetëm një instrument i thjeshtë ritmi që zëvendësonte orkestrën, i thjeshtë



por i bashkuar me zërin e vajzave, me këngët e tyre i dhanë hare ambientit. Ishte grua ajo që i binte orkestrës, e sa bukur fytyra e saj fisnike nuk reshti duke buzëqeshur.

Ishte moment i bukur, kur me instrumentin e saj kjo vajzë u grit dhe hyri në mesin e vajzave tek vallëzonin dhe me shpirt interpretonte. E pyeta se ku e kish mësuar. Vetë - më tha. - Ma do shpirti këngën, i bie edhe në shtëpi. U habita me këtë realitet të bukur të tyre, këndojnë, vishen, falen e luten së bashku në harmoni edhe me fëmijët e tyre, e thjesht mendova sa mirë e kanë gjetur bukur lumturinë familjare.

Një vajzë tjetër, ajo që ligjëronte për to një herë në javë tema nga islami, erdhi me gëzim pranë meje e më shpjegoi gjithçka të bukur që ndodhte në këtë shtëpi, kur merrnin mësimet e përkujtime nga realiteti islam në kohë profetësh. Janë 13-14 vajza, të gjitha që studiojnë në fakultete të ndryshme, shkëlqejnë në mësimet, por edhe në mësimet jashtë shkolle siç janë ligjeratat islame -shprehet ajo.

Unë tek e dëgjoja që fliste me aq vlerësim e simpati për to në mendjen time kishte zënë vend ideja: Lum ata bashkëshortë që do kenë fatin t'i kenë ato për bashkëshorte dhe nëna të fëmijëve të tyre. Të bukura, të sjellshme, të moralshme, të arsimuara e mbi të gjitha besimtare, që ashtu siç e predikon feja jonë.

Ky takim më largoi lodhjen dhe mërzitjen. E ndjeva veten jo vetëm të kënaqur, por të lumturuar. Sepse tek këto vajza pashë jo vetëm besimtare, por edhe ato që dinë të të rrespektojnë, të studiojnë, të vishen bukur, dinë dhe të vallëzojnë, të këndojnë plot vitalitet që karakterizon vetë moshën e tyre. Ndaj pati aq gëzim ky takim. Ata gëzonin për "tjetrën" e kjo më ngeli në mendje, gëzuan

si për veten e tyre. Unë me këto pak rradhë desha t'ju kthej mirënjohjen dhe kënaqësinë që ndjeva ato 4-5 orë të atij takimi. Kam qenë edhe në raste të tjera por bukurinë e asaj pasditeje ende vazhdoj ta kujtoj. I falendëroj ato, por falendëroj gjithashtu atë njeri që u bë shkak që ky grup vajzash të jetojnë bashkë, të ndajnë eksperiencat të bukura jete në një metropol si Tirana, me plot probleme, por që mëshira e Zotit dhe më pas mirësia e tij bëri që këto të jetojnë pa pasur problem, mbi shpatullat e studenteve plot stresa, krizën ekonomike familjare që ka pllakosur kudo e duke i stimuluar ato për dije, arsim e kulturë fetare.

Nga: Manushaqe Salianji - shkrimtare

Më pas, veç kësaj ata përtej atyre mureve të shtëpisë nuk dinë vetëm të bëjnë banjo dielli siç bëhet në B.B., por një aktivitet i tyre vjen nën logon: "Atje lart nuk është aq errët sa imagjinohet". Një simpozium organizuar nga këto 14 vajza me në krye mësueset e tyre të tematikave fetare, Ada Kocani e Edlira Dyrmishi sollën para një auditori nota vërtet studimi mbi këtë temë, porë në këndvështrimin shkencor të asaj çfarë sjell islami si argument për njerëzit, për besimin, kulturën e shpëtimit.

-Aktivitetet tjetër i rradhës ishte ai i mbylljes së Institutit të dijes, institut që shënon mbylljen e një 3-vjeçari studimesh të kordinuara socialo-fetare, ku përfitueset janë më së shumti gra e nëna me fëmijë, por që kurorëzohen me shumë mirësi për atë çfarë dinë t'i japin vlere dijes e kërkimit të saj edhe përmes sakrificave prej nëne, prej bashkëshorteje etj.

Aktivitetet vazhdojnë nën logot: "Dua t'ju befasoj" dhe "Grua e ditur" aktivitete të cilat në qendër të tyre kanë konkursin e librit, me qëllim nxitjen e grave edhe gjatë pushimeve verore të mësojnë e të lidhen ngushtë me librin, si porosi kjo prej profetit të fundit ndaj dijes së dobishme, lënia pas e së cilës do na humbiste të gjithëve, Zoti na ruajtë nga humbja e dijes!

ADEMI

nga Irfan Tota

Tregimet e profetëve përmbajnë shumë vlera dhe dobi për të zotët e mendjes. Zoti i Lartë thotë: “Në tregimet e atyre (të dërguarve) ka këshilla për ata që janë me mend. Ky (Kur’an) nuk është tregim i trilluar, por ai është vërtetues i librave që janë shpallur para tij, është shpjegues i çdo gjëje dhe udhërrëfyes e mëshirë për njerëzit besimtarë.” (Jusuf 111)

Në tregimet e tyre gjen dritë dhe udhëzim, ngushëllim dhe vendosmëri. Aty zbulon dhe mëson si të durosh dhe të përballosh vështirësitë e vuajtjet në rrugën e thirrjes për në besimin e pastër. Tek këto tregime shikojmë moralin e lartë dhe edukatën shembullore të profetëve me Zotin, pasuesit dhe kundërshtarët e tyre. Tek ata gjejmë se si ata qëndronin larg mëkateve, se sa shumë dhe me përkushtim adhuronin Zotin dhe se si Ai i ndihmonte ata dhe asnjëherë nuk i poshtëronte. Madje përfundimi i tyre ishte shumë i mirë, ndërsa kundërshtarët e profetëve kishin pasojat më të dhimbshme.

Në këto tregime ne marrim shembull nga këta njerëz të përzgjedhur nga Zoti i gjithësisë sipër shtatë qiejve, sepse ata janë shembulli më i mirë që meritojnë të ndiqen e të pasohen në çdo kohë e në çdo vend.

ADEMI (alejhi selam), I PARI PREJ PROFETEVE

Zoti thotë në Librin e Tij: “Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë do të krijoj një mëkëmbës (që do të zbatojë ligjet e Zotit) në tokë”, ata thanë: “A do të vësh atje dikë që do të bëjë çrregullime e do të derdhë gjak në të, ndërkohë që ne të madhërojmë, të lavdërojmë dhe të lartësojmë ashtu si të takon Ty?!” Ai tha: “Unë di atë që ju nuk e dini”. Zoti ia mësoi Ademit emrat e çdo gjëje, pastaj ua paraqiti engjëjve dhe u tha: “Më tregoni emrat e tyre, nëse ajo që thoni është e vërtetë!” Qofsh i lavdëruar! – thanë ata – ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti.



Në të vërtetë, Ti je i Gjithëdituri, i Urti." O Adem – tha Ai – tregoju atyre emrat e gjërave!" Kur ai ua tregoi emrat e tyre, Zoti tha: "A nuk ju kam thënë se vetëm Unë i di fsheshtësitë e qiellit e të Tokës dhe Unë di çfarë tregoni haptazi dhe çfarë fshihni?!" Kur u thamë engjëjve: "Përluni në sexhde para Ademit", ata u përlunë, përveç Iblisit, i cili nuk desh, u tregua mendjemadh dhe u bë mosbesimtar. Ne thamë: "O Adem, jeto ti dhe gruaja jote në Xhenet dhe aty hani sa të doni e kur të doni, por mos iu afroni kësaj peme, se ndryshe do të bëheni të padrejtë". Shejtani i shtyu të gabojnë e i nxori nga lumturia ku ishin. "Zbritni – u thamë. Ju, do të jeni armiq të njëri-tjetrit. Në Tokë do të qëndroni, do të keni furnizim e do të jetoni deri në një kohë të caktuar". Ademi mësoi disa fjalë (se si të kërkonte falje) nga Zoti i tij, kështu që Ai ia pranoi pendimin. Sigurisht, Ai i pranoi shumë pendimet, Ai është Mëshirëploti. Ne u thamë: "Zbritni të gjithë prej Xhenetit! Kur t'ju vijë udhërrëfimi Ynë, ata që do t'i përmbahen atij, nuk do të kenë frikë dhe nuk do të dëshpërohen. (Bekare 30-38)

Kurse Profeti Muhamed ka thënë: "Vërtet që Zoti e krijoi Ademin nga një grusht dhe që e mori nga të gjithë llojet e Tokës, prandaj edhe pasardhësit e tij, i përngjasonin asaj; kishte prej tyre të bardhë, të kuq, të zinj apo ndërmjet këtyre ngjyrave. Prej tyre doli njeriu i keq, i mirë, i butë, i binduri dhe ai me natyrë të egër dhe të tjerë mes këtyre llojeve. (hadith i saktë)

Zoti e krijoi nga balta dhe e la në atë formë për dyzet vjet. Kur engjëjt kaluan pranë tij, u tmerruan kur e panë dhe Iblisi ishte ai që u frikësua më shumë. Djalli kur kalonte pranë tij, e godiste dhe trupi i tij nxirrte një zë ashtu siç del nga qypi.

Pastaj iu tha engjëjve: Mos kini frikë nga ai, sepse është i boshatisur, kurse Zoti juaj nuk është i tillë. Djalli thonte: Patjetër që është krijuar për diçka, nëse do mund ta mposht do ta shkatërroj. Për këto fjalë dëshmon fjala e Profetit, i cili thotë: "Kur Zoti e formoi Ademin në xhenet, e la aty aq sa dëshiroi. Kurse Iblisi sillej rrotull tij duke parë me vëmendje. Kur e pa nga brenda se ishte i boshatisur, e kuptoi se ai është i krijuar dhe nuk mban dot veten e tij." (Muslimi)

Kur Zoti i lajmëroi engjëjt se do të vendosë në Tokë një mbikqyrës, e pyetën për urtësinë e këtij krijimi dhe jo në formë kundërshtimi. Ose pyetja e engjëjve ishte nga frika se ndoshta mos ata vetë kanë lënë diçka mangut apo kanë bërë ndonjë shkelje dhe menjëherë nxituan për të shfajësuar vetet e tyre duke thënë: Ne të lartësojmë dhe të madhërojmë. Pastaj Zoti ia mësoi Ademit emrat e çdo gjëje me të cilat duhej të njihej njeriu. I mësoi emrat e maleve, të luginave, të lumenjve, të deteve, etj. Pas kësaj Zoti kërkoi nga engjëjt që t'i tregojnë për emrat që i mësoi Ademit. Engjëjt u përgjigjën me përlulesinë më të madhe duke thënë: "Qofsh i lavdëruar! - thanë ata - ne

dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti. Në të vërtetë, Ti je i Gjithëdituri, i Urti." Më pas Zoti e urdhëroi Ademin që t'ju tregonte emrat që dinte dhe ai e bëri një gjë të tillë.

Në ajetet që vijojnë Zoti urdhëroi engjëjt që t'i bëjnë sexhde Ademit sapo t'i fryhej shpirti. Të gjithë engjëjt ranë në sexhde, e cila ishte një përshëndetje për ardhjen e Ademit në këtë botë, kurse Iblisi, refuzoi nga mendjemadhësia dhe s'mira, duke u justifikuar me një dyshim djallëzor ku tha: "Unë nuk i përulëm një vdekatar që Ti e ke krijuar nga balta e thatë e marrë prej baltës së zezë pa formë." (Hixhr 33) gjithashtu tha: "...Unë jam më i mirë se ai. Mua më krijove nga zjarri, kurse atë e krijove nga balta".

Iblisi i mallkuar mendoi se zjarri është më i mirë se balta dhe se elementët përbërës të zjarrit janë më të mirë se ato të baltës, atëherë si mund të binte në sexhde! Nuk e kuptoi injoranti se sexhdja për Ademin ishte një bindje ndaj Zotit, mirëpo s'mira dhe mendjemadhësia nuk e lanë që ta bënte këtë. Edhe elementet përbërëse të baltës janë më të mira se ato të zjarrit, sepse zjarri ka cilësi që të jetë i lehtë dhe i djegshëm, kurse balta ka si karakteristikë: e përmbajtur, elastike, më e dobishme, etj. Kur Iblisi nuk pranoi që të bënte sexhde, u përzu nga bota e engjëjve me fjalën: "Dil prej xhenetit! Ti je vërtet i mallkuar!" (Hixhr 34) Thuhet se Iblisi ishte i nderuar dhe i respektuar. Mirëpo kur kundërshtoi Zotin u largua dhe u përzu. Kur Iblisi e pa se



vërtet do të largohet nga ajo mirësi, i kërkoi Zotit që t'i jepte afat deri Ditën e Gjykimit dhe Ai pranoi: "Iblisi tha: "Zoti im, më jep afat deri në ditën kur ata do të ringjallen!" Zoti tha: "Sigurisht që do të të jepet afat deri në një ditë të caktuar." (Hixhr 36-38)

Kur Iblisi u sigurua me afatin që i dha Zoti tha: "Iblisi tha: "Zoti im, për shkak se më çove në humbje, unë do t'u zbukuroj atyre (njerëzve) rrugën e gabuar në Tokë dhe të gjithë do t'i shpie në mashtrim, përveç robërve të Tu të sinqertë". (Hixhr 39-40)

Kështu, Iblisi shpalli armiqësinë ndaj Ademit nga momenti që u mallkua.

Zoti krijoi dhe bashkëshorten e Ademit, Havanë, që të gjente qetësinë tek ajo. Iu tha atyre që të qëndrojnë në xhenet dhe të përjetojnë kënaqësitë e tij dhe i ndaloi nga ngrënia e një peme, duke thënë që të kenë kujdes nga mashtrimi i shejtanit: "Pastaj thamë: "O Adem. Me të vërtetë që ky është armiku yt dhe i gruas tënde, prandaj mos e lini t'ju nxjerrë kurrsesi nga xheneti se pastaj do të vuani në mjerim." Mirëpo Iblisi ua zbukuroi ngrënien e pemës duke përdorur të gjitha format, madje u betua se është një këshillues besnik për ta duke iu thënë: "O Adem, a do të të tregoj pemën e përjetësisë dhe të një mbretërimi që nuk zhduket?" (surja Ta Ha 120)

E quajti pemën e përjetësisë me qëllim që Ademi dhe Havaja të kishin lakmi për pemën. Në një ajet tjetër iu tha: "...Zoti juaj jua ka

ndaluar pemën, vetëm që të mos bëheni engjëj ose të pavdekshëm." (surja Araf 20) Këtë e theksoi duke u betuar: "Dhe iu betua atyre (duke thënë): "Vërtet, Unë jam për ju këshillues i sinqertë!" (surja Araf 21). Kur u betua se është një këshillues dhe këtë e bënte se ju don të mirën e tyre, Ademi dhe Havaja u mashtruan pas këtyre fjalëve dhe hëngrën nga pema e ndaluar: "Dhe i mashtrroi me dinakërinë e tij. Pasi e shijuan frutin, atyre iu zbuluan vendet e turpshme dhe nisën të mbuloheshin me gjethet e Xhenetit..."

Kur Ademi dhe Havaja kundërshtuan Zotin, filluan që të shfaqen pjesët e turpshme, sepse gjynahu gjithmonë sjell pasoja. Zoti u tha: "... A nuk jua kisha ndaluar atë pemë? A nuk ju pata thënë se djalli është vërtet armiku juaj i hapur?" (surja Araf 22)

Ademi dhe Havaja u penduan tek Zoti dhe e pranuan që kishin gabuar dhe i kërkuan Zotit që t'i falte: "Ata thanë: "O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi nga të humburit!"

Shikoni suksesin që Zoti i dha Ademit, i cili e kundërshtoi, kurse Zoti e orientoi për t'u penduar dhe ai u pendua dhe kërkoi falje dhe Zoti ia pranoi këtë. Kurse Iblisi kur e kundërshtoi Zotin, u poshtërua dhe nuk kishte sukses për t'u penduar, madje kërkoi afat që të çonte njerëzit në humbje dhe t'i devijonte nga rruga e drejtë.

Mirëpo pendimi i Ademit u shoqërua me daljen e tij nga xheneti. Zoti e zbriti bashkë me gruan e tij në Tokë dhe bashkë me to edhe Iblisin e mallkuar: "Zoti tha: "Zbritni! Ju do të jeni armiq për njerëzit. Në Tokë do të banoni dhe do të jetoni deri në një kohë të caktuar. Aty do të jetoni, aty do të vdisni dhe prej saj do të ringjallen!" Ademi dhe Havaja jetuan në Tokë dhe prej tyre lindën pasardhës të shumtë.

Nuk dihet me saktësi sa ka jetuar Ademi.

Transmeton Ebu Hurejre se Profeti ka thënë: "Kur Zoti e krijoi Ademin, i fërkoj kurrizin e tij dhe nga aty ranë të gjitha shpirtrat që Zoti do të krijojë nga pasardhësit e tij deri Ditën e Fundit. Tek çdo njeri kishte vendosur një shkëlqim drite mes dy syve dhe më pas iu paraqitën Ademit. Ademi tha: O Zoti im! Kush janë këta? Ai tha: Këta janë pasardhësit e tu. Prej tyre pa një burrë që i pëlqeu dhe drita mes dy syve i shkëlqente më shumë: O Zoti Im! Kush është ky? Ky është një burrë nga të fundit e popullit tënd, që quhet Daud. O Zoti Im! Sa vjet ia ke cakuar jetën? 60 vjet. O Zoti im, shtoi edhe 40 të tjera nga vitet e mia. Kur Ademi i mbaruan vitet e jetës, i erdhi engjëlli i vdekjes. Ademi i tha: A nuk më kanë ngelur edhe 40 vjet? A nuk ia ke dhënë birit tënd Daudit? – i tha engjëlli. Ademi e mohoi këtë dhe pasardhësit e tij i mohojnë si ai, harroi Ademi dhe pasardhësit e tij harrojnë si ai, gaboi Ademi dhe pasardhësit e tij gabojnë siç gaboi ai." (Tirmidhiu,)



“Dhe mbahuni fort, të gjithë ju së bashku, pas Litarit të Zotit (Kur’anit) dhe mos u ndani (mos u përçani) dhe mbani në mendje Mirësinë e Zotit ndaj jush, kur ju (para se të pranoni fenë) ishit të armiqësuar, por Ai bëri bashkimin mes zemrave tuaja, dhe ashtu me Dhuntinë e Tij ju u bëtë vëllezër (në besimin Islam). Madje ishit në buzë të greminës së zjarrit, e Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Zoti ua sqaron juve argumentet e Veta, që ju të drejtoheni (të mund të gjeni të vërtetën e lumtur)”.

[Ali-Imran:103]

Së bashku ... më mirë

nga: Amina Ndreu

Sa herë që lexohet ky ajet, në zemër ndjen një mallëngjim, ndjen sikur ky ajet na përshtatet aq shumë ne! Sa shumë është folur për unitetin në Islam! Sa shumë rëndësi i vuri Kur’ani atij! Sa shumë e kërkuan unitetin të Dërguarit e Zotit, që prej Ademit e deri tek Profeti i fundit Muhamedi, paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të, dhe sa shumë kanë folur dijetarët për të!

Dhe e gjithë kjo, jo pa qëllim, por me qëllim që Fjala e Zotit të jetë më e Larta, myslimanët të jenë populli më i privilegjuar në këtë botë dhe që Zoti e i Dërguari i Tij të jenë të kënaqur me ne.

Ideali ynë i përbashkët është se të gjithë besojmë në një Zot, në të Dërguarin

e Fundit, në një libër, të cilat janë pikat kryesore që na lidhin, dhe sa për mendimet, apo ritet, apo imitimet etj., ato nuk duhen të jenë e as të bëhen shkak largimi nga njëri-tjetri e aq më pak për t’u ndarë.

Është shqetësim shumë i madh kur mes myslimanëve ka përçarje, dhe të dish që këto përçarje nuk kanë lidhje me ato që përmendëm më sipër. Fjala “përçarje” është shumë e rëndë, të themi krisje mes “safeve”, por kujdes vëllezër dhe motra, këto krisje sado të vogla duken përbëjnë një rrezik shumë të madh për bashkësinë tonë fetare.

Para çdo interesi vetjak myslimani vendos interesin e bashkësisë ku ai jeton, ku ai mëson dhe ku ai punon. Ne të gjithë jemi pjesë e kësaj bashkësie, e cila bën pjesë në bashkësinë më të madhe të botës.

Dhe nëse të gjitha bashkësitë janë të forta aq më i fortë do të jetë arena besimtare në mbarë botën.

Çdokush t'i kthehet vetes së tij, t'a analizojë atë, t'i thotë egos së tij: Stop!, mjaft më me egoizëm, mjaft më me fjalë boshe, mjaft më me zilinë, xhelozinë, me fjalë provokuese, mjaft më me fjalë të kota! Le t'i themi njëzëri: jo injorancës. Të jemi vëllezër dhe motra! A do të dëshiroje ti që të flitet keq apo të përflitet për vëllain dhe motrën tënde nga gjaku? -Kurrësesi jo!

Duhet të dimë që mbi çdo gjë vendoset interesi i përbashkët, dhe jo ai vetjak, apo i një grupi në veçanti. Jo më kot në fjalët e Kur'anit u tërhiqet vëmendja besimtarëve në përgjithësi: "*O ju që keni besuar...*", kjo për vetë faktin se Zoti ashtu siç na ka udhëzuar ashtu kërkon prej nesh të jemi të bashkuar. Kjo arrihet vetëm duke rregulluar vetet tona, duke çrrënjësuar inatin, xhelozinë, mërinë, të cilat janë veçse sëmundje të zemrës. Për çdo shqetësim të tillë në zemër, ajo shënjohej me një pikë të zezë...!

Çdonjëri është i vetëdijshëm për atë që bën, por nëse ai bën diçka që e lëndon tjetrin, atëherë zemra e tij ngushtohet, dhe vetë ai "sëmuret", nuk është i qetë, sepse vetja e tij e mundon. Dhe për çfarë mundohet ai?! ...për t'i bërë keq vëllait apo motrës së tij, apo ndonjë grupi në veçanti.

A i keni lexuar apo dëgjuar fjalët e Profetit tonë në lidhje me këtë?!

"Mos e kini s'mirë njëri-tjetrin, mos e mashtroni njëri-tjetrin, mos e urreni njëri-tjetrin, mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit, mos i ndërhyjni njëri-tjetrit në shitblerje, dhe bëhuni vëllezër, o robër të Zotit! Muslimani është vëlla i myslimanit, nuk i bën padrejtësi atij, nuk e lë në baltë, nuk e gënjen dhe nuk e poshtëron. Devotshmëria është këtu!" - dhe bëri me shenjë në kraharorin e tij tre herë.

"Për një njeri është shumë keq që ta nënçmojë vëllain mysliman. Çdo mysliman e ka të ndaluar gjakun e një myslimani, pasurinë dhe nderin e tij".

Kjo thënie është shumë me vlerë!

A e kupton njeriu ziliqar, se nuk i bën dëm atij ndaj të cilit drejton smirën e tij? A e kuptojmë ne se çdo të thotë të mashtosh myslimanin? - Pse, o vëlla ia kthen shpinën vëllait tënd, pse nuk e përshëndet atë, pse ndjehesh keq kur atë e shikon mirë, të arrirë në profesionin e vet? Pse o motra ime ia kthen shpinën aq lehtë motrave të tua?

A nuk ishim të gjithë ne që u betuam në vetet tona, kur pranuan Islamin, që ta nderojmë atë (Islamin)? Por, si u nderoka Islami kur ne jemi të ndarë për interesa vetjake?!

Muslimani më mirë se askush tjetër, e di se kjo botë është mashtruse, është e përkohshme. Imagjinoni sikur të na vijë vdekja dhe ne i kemi bërë padrejtësi vëllait apo motrës sonë...

Po nëse ndodh ndonjë fatkeqësi, a nuk do të mundoheshim ne për të ndihmuar njëri-tjetrin, për të shpëtuar pjesëtarët e familjes sonë?

E pra, ta konsiderojmë njëri-tjetrin pjesëtar të një familjeje, gjymtyrë të një trupi, ashtu siç na ka krahasuar i Dërguari dhe nëse një gjymtyrë lëndohet, dhemb i gjithë trupi. Çdo mysliman është përgjegjës për veten e tij, dhe përgjegjës për bashkësinë ku ai jeton. *Meqënëse ne jetojme në një vend ku Islami shihet me syrin kritik dhe injorues, "arma" jonë më e fortë është bashkimi ynë, harmonia, dashuria për njëri-tjetrin, dialogu institucional dhe individual, tolerimi ndaj njëri-tjetrit pa lënduar askënd, dhe më kryesorja: ajo që mësohet, të vihet në praktikë.*

Hadithi (thënia) e parë që mësohet në çdo shkollë islame është mbi qëllimin (nijetin), mbi sinqeritetin, që gjithçka të bëhet vetëm për të arritur Kënaqësinë e Zotit.

O Zot, na bëj prej atyre që e dëgjojnë fjalën dhe i përmbahen më të mirës së saj!

Jmendje të çoroditura e shpërtra të trazuar

Vlerat e një populli përcillen ndër breza nga personalitete e njerëz me zemër të madhe, që nuk njohin egoizmin, mendjemadhësinë e smirën. Ata veç kthjellojnë mendjet, qetësojnë shpërtrat dhe i bëjnë njerëzit të përgjegjshëm për atë që duhet të luftojnë e të synojnë në jetë.

nga: Jerida Kulla

Nga një vështrim i shpejtë i historisë së zhvillimit të besimeve fetare, jo vetëm në vendin tonë, por edhe në ato të rajonit, vihen re se ka të përbashkëta, që i afrojnë, por dhe të veçanta, që i dallojnë. E, në këto të fundit, Shqipëria, si dhe në jo pak fusha të tjera, ka veçoritë e veta, herë pozitive dhe herë jo. Kështu, në asnjë vend të rajonit, madje dhe më gjerë, besimet fetare nuk janë ndaluar siç u bë tek ne nga regjimi komunist. Por, një e veçantë tjetër, që jo pa mburrje e përmendin shpesh politikanët tanë, sikur të ishte fryt i punës dhe i përkushtimit të tyre, është modeli shqiptar i harmonisë ndërfetare, model që shpesh i referohen edhe studiues të huaj, disa prej të cilëve, nga mungesa e informacionit ose nga keqdashja, dalin në përfundime të cinguarra e jo të vërteta. Nuk është i rëndësishëm thjesht fakti që krerët e besimeve fetare në Shqipëri i shohim bashkë në ngjarje të mëdha, ditë përkujtimore e festa kombëtare. Natyrisht, kjo ka rëndësi jo thjesht simbolike. E rëndësishme është respektimi i besimit të njëri-tjetrit nga vetë besimtarët dhe mirëkuptimi për atë çka i intereson komunitetit ku jetojnë e kudo që ndodhen. Në shumë fshatra e zona në Shqipëri nuk i bën njeri përshtypje, që një nga dy vëllezërit e një familjeje myslimane ka marrë për grua vajzën e një familjeje të besimit ortodoks apo katolik. Një gjë e tillë nuk është se ka lindur në ditët e sotme, ajo vjen nga larg, shumë vite më parë.

Në vitet e demokracisë, pas ndrydhjes për disa dekada nga regjimi komunist, ka një frymëmarrje të gjerë e të thellë të besimeve, që duket që nga besimtari i çliruar nga frika e ankthi e deri në tërë rrjetin e ngritur me mund e vështirësi të institucioneve fetare dhe të objekteve të ndryshme sociale, arsimore e kulturore, si: kopshte, shkolla, qendra kulturore, radio, shtëpi botuese, shtypshkronja, revista, literaturë fetare e shkencore, etj., që në themel kanë orientimin fetar. Por, megjithëkëtë klimë të shëndetshme, aty-këtu duken e ngrejnë krye edhe shfaqje e dukuri të dëmshme, që bëhen shkak për prishjen e qetësisë dhe të harmonisë jo vetëm të besimtarëve, por të gjithë shoqërisë. Besimtarët myslimanë, në Shqipëri, janë në shumicë, krahasuar me besimtarët e feve të tjera. Ky fakt ndokujt do t'i krijonte mendimin se qëndrimi e sjellja e tyre do të ishte jo pa probleme. Në fakt nuk ndodh kështu. Sa herë ka pasur, në njërën apo tjetrën mënyrë, shfaqje të vogla e sporadike, që mund



të çonin në prishjen e mirëkuptimit e të harmonisë midis besimtarëve të feve të ndryshme, në fshat, qytet apo zona të tëra, gjithmonë kanë dalë njerëz që dinë të trajtojnë me durim e urtësi problemin dhe kanë kthjelluar mendjet e çoroditura e qetësuar shpirtat e trazuar.

Megjithëkëtë, kohët e fundit janë mbajtur qëndrime të ashpra deri në mos lejimin e vazhdimin të studimeve të vajzave që shkonin në fakultet me kokën mbuluar me shami, me arsytimin, nga drejtuesit e institucioneve, se nuk e lejon rregullorja e shkollës. Nëse harton një ligj apo rregullore, në kundërshtim të hapur me liritë e të drejtat themelore të njeriut, natyrisht që në një argumentim të tillë, që e ke stisur vetë, do të biesh. Në shkollë, për vetë natyrën e saj, rregullorja përcakton edhe detyra e të drejta që nuk janë për qytetarët në përgjithësi, por nëse ato nuk prekin procesin e formimit edukativ dhe atë arsimor të nxënësit e studentit, por edhe të kolektivit, nxënësit dhe studentit nuk ka pse t'i bëhet kufizimi, fjala vjen në rastin konkret i përdorimit të shamisë nga ato vajza që e dëshirojnë atë, ashtu siç nuk kufizohet mbajtja e kryqit varur në qafë nga vajza apo djali i një feje tjetër, që janë në të njëjtën klasë apo shkollë. Qëndrime të tilla ndaj përdorimit të shamisë ka edhe në vende të zhvilluara të Evropës, ku në çdo klasë është i vendosur në mur Krishti i kryqëzuar, pavarësisht se në klasë ndodhen studentë të feve të ndryshme. Në ato vende numri i besimtarëve të fesë islame është i vogël. Edhe në to, natyrisht, reagimet janë të ndryshme e përfshihen edhe personalitete politike, shkencore dhe fetare, krahas qytetarëve të thjeshtë besimtarë ose jo.

Kohët e fundit në vende dominuese në Shqipëri, nga ku mund

të shihen sa më shumë, jo në një rast janë ngritur, rrëzuar e ngritur përsëri kryqet të mëdhenj, që me të drejtë, në një ose tjetrën mënyrë, krijojnë reagim të besimtarëve myslimanë. Çdo fe ka programin e strategjinë e saj për shtimin e besimtarëve në tërësi dhe të besimtarëve praktikantë në veçanti. Dhe kjo është normale, e natyrshme. I panatyrshëm është provokimi që bëhet nga misionarë të ndryshëm, edhe pse jo të shumtë, që mundohen e manipulojnë besimtarë të një feje e i shfrytëzojnë ata për të provokuar besimtarët e një feje tjetër, siç janë edhe rastet e vendosjes së kryqeve.

Klerikë të huaj dhe shqiptarë, herë pas herë janë bërë të njohur nga media, për fytyrën e vërtetë të tyre, ndryshe nga ajo që janë munduar të shfaqin para besimtarëve. Probleme të moralit, mashtrimet, falsifikimit, grindjet e sherret për poste e prona, etj., kanë bërë që jo vetëm qytetarë të zakonshëm, por edhe besimtarët të jenë të kujdesshëm e të mos bien pre e njerëzve që kanë veshur petkun e misionarit fetar, për ta shfrytëzuar atë për qëllime të ulëta e të dënueshme rreptësisht nga feja dhe ligji.

Undërtuan shumë xhami, ashtu siç u ndërtuan dhe shumë kisha, krahas atyre të paktave që regjimi i la thjesht si monument kulture, që sipas tij, t'i tregohej brezave të ardhshëm, se nga këto institucione fetare i transmetohej popullit e pa vërteta. Një xhami e tillë është edhe ajo e Et'hem Beut, në qendër të Tiranës, në kryqëzim rrugësh e qarkullim të madh të mjeteve e kalimtarëve. Falja në trotuar dhe shesh e besimtarëve ditën e premtë, në atë mjedis zhurme dhe kaosi, është krejtësisht e papërshtatshme dhe nuk është në nderin e besimtarëve. Ashtu sikurse janë zgjidhur shumë probleme të vështira e të ndërlikuara, mund e duhet të ishin zgjidhur në

PASQYRË

kohë dhe problemet e pronave e të ish-in ndërtuar xhami me madhësinë e duhur, por edhe me sheshin e nevojshëm të tyre për të përballuar fluksin e besimtarëve.

Për besimtarët myslimanë, familja, ka qenë dhe ngelet e shenjtë dhe është trajtuar me kujdesin më të madh, por në kushtet e sotme të globalizimit, problemet e saj janë bërë më delikate e të brishta. Familja është tronditur e trazuar shumë, ndaj dhe kërkohet të mbahen më të forta e të shëndetshme si lidhjet e dashurisë e të besimit të ndërsjellë midis bashkëshortëve, ashtu dhe dashuria e respekti i fëmijëve ndaj prindërve. Por, lëvizjet e qarkullimi i ideve, njerëzve, kapitaleve e teknologjive, sot është bërë kaq ishpejtë dhe ndryshimet janë kaq të mëdha, sa është e pamundur të sigurosh sukses, të arrish qëllimin me frazeologji të përgjithshme e pa nerv, me sjellje dhe qëndrime të rëndomta që as ngrohin, as ftohin njeri, pa "investim" të gjerë e të thellë të mendimit krijues e argumentit bindës, në përshtatje me nivelin, hallin e problemet që ka besimtari. Këto janë pasuri të njerëzve të aftë e të përkushtuar, që i japin fesë dimensionin shpirtëror dhe social të kohës. Dhe këta asnjëherë nuk i kanë munguar besimit islam, por kanë qenë të pranishëm në tërë hierarkinë fetare, duke dhënë kontributin e tyre të çmuar në çdo kohë. Ndonjë, që gabimisht ndodhet i rreshtuar në grupin e misionarëve të fesë, që jo vetëm me punën, por edhe me prezantimin e tij në publik, le shumë për të dëshiruar, nuk mund të errësojë aspak punën gjithë pasion e dashuri të shumë e shumë të tjerëve.

Vështirë të ketë ngelur ndonjë qytetar pa u takuar me disa punonjës fetarë, themi punonjës se ata nuk mund të jenë besimtarë, punonjës të një feje që nuk është ndjerë më parë,

por që janë shumë të bezdisur dhe që nuk është e lehtë të shkëputesh prej tyre. Në vend që me punën e tyre të çlodhin besimtarët, që duan të afrojnë e mbushin jetën me sa më shumë ngjarje e gëzime, i predikojnë një jetë boshe, të zbehtë, duke i broçkollitur lloj-lloj hollësirash pafund për jetën e përtejme e të tjera si këto. Nga media, jo pak herë është bërë e ditur se fëmijë, që i kanë dhënë fund jetës së tyre, në një formë ose në një tjetër, kanë marrë pjesë në aktivitetet e organizuara nga këta punonjës. Është fakt, që në këto vitet e demokracisë, në vendin tonë, janë ngritur edhe shumë shoqata e fondacione, që në licencat e tyre kanë veç të tjerave, ose mbi të tjerat, veprimtarinë për kulturimin, bamirësinë dhe besimin e qytetarëve. Se kush është "bulmeti" i tyre për njeriun e familjen e sa të vërteta janë ato, vështirë se mund t'i përgjigjet saktë kush. Vlerat e një populli përcillen ndër breza nga personalitete e njerëz me zemër të madhe, që nuk njohin egoizmin, mendjemadhësinë e smirën. Ata veç kthjellojnë mendjet, qetësojnë shpirtat dhe i bëjnë njerëzit të përgjegjshëm për atë që duhet të luftojnë e synojnë në jetë. Në çdo periudhë të historisë familja ka pasur veçoritë e problemet e saj, por sot ato janë më të vështira, më të ndërlikuara e tepër komplekse, ku ndërthuren shumë faktorë, sa shpirtërorë, aq edhe ligjorë, sa ekonomikë, aq edhe kulturorë e arsimorë, sa modernë, aq edhe klasikë, etj., që kërkojnë interesimin ,punën e përgjegjësinë e individit, shoqërisë, shkollës, shtetit e padyshim të institucioneve fetare, nga ku merr edhe dimensionin e vërtetë shpirtëror, pa të cilin njeriu, familja, vetë jeta nuk do të kishin kuptim. Kështu do të kishim pak mendje të çoroditura dhe pak shpirta të trazuar.

Asija, gruaja e Faraonit

Asija, e bija e Muhazimit, gruaja e Faraonit, shembulli i durimtares dhe besimtares së sinqertë për të gjithë njerëzit pa dallim gjinie.

Zoti thotë në Kur'an:

"E atyre që besuan, Allahu u solli shembull gruan e faraonit kur ajo tha: 'O Zoti im, më ndërto një shtëpi në xhenet dhe më shpëto nga faraoni dhe veprat e tij si dhe më shpëto nga njerëzit mëkatarë.'" (Tahrim: 11)

Kjo grua fisnike përmendet në historinë e profetit Musa.

Kur'ani përmend shtypjen, padrej-tësitë dhe keqtrajtimin ç'njerëzor që u bënte Faraoni popullit të izraelit.

Ai gëzonte pushtetin më të lartë në Egjipt. Ishte ai që vendoste për gjithçka dhe askush nuk kishte të drejtë ta kundërshtonte. Ai kishte arritur t'i përçajë njerëzit duke i ndarë në shtresa të shumta, me qëllim që t'i kontrollojë më kollaj *"Me të vërtetë që Faraoni madhështoj në Tokë dhe banorët e saj i kishte përçarë në grupe. Disa prej tyre i përndiqte, ua vriste fëmijët meshkuj, ndërsa femrat ua linte gjallë. Ai ka qenë vërtetë keqbërës."* (Kasas: 4). Gjithashtu ai vriste të gjithë foshnjët (djem) që lindnin. Vrasja ishte gjëja më e lehtë për të dhe për ushtarët e tij besnikë. Në të gjithë historinë njerëzore nuk është shënuar masakër më e rëndë se ajo e faraonit.

Po cili ishte shkaku i saj dhe përse sillej kështu Faraoni me të bijtë e izraelit?

Ai pa në ëndërr një zjarr që dilte nga shtëpitë e bijëve të Izraelit dhe i sulej pallateve të tij, duke i djegur bashkë me Faraonin dhe ushtarët. Kjo ëndërr e dëshpëroi shumë dhe menjëherë ai mblodhi fallxhorët e tij, të cilët i thanë: "Një foshnjë që do të lindë tek Benu Israilët do të rrëzojë ty nga froni mbretëror".

Foshnja, i cili shpëton nga bijtë e izraelit është Musai, për shkak të frymëzimit që i jep Zoti nënës së tij ta hedhë me arkë në lumë. *"Kështu ne e frymëzuam nënën e Musait: 'Jepi gjatij dhe kur të trembesh për sigurinë e tij, hidhe në lumë, pa pasur frikë dhe as dëshpërim. Me siguri që ne do ta kthejmë e do ta bëjmë të dërguar.'" (Kasas: 7)*

Arka me Musanë brenda e çoi atë në bregun pranë pallateve të Faraonit.

Kur gruaja e faraonit e pa atë fëmijë në arkë, Allahu bëri që zemra e saj të mbushej me dashuri e mëshirë për të. Kjo është mirësi nga Zoti, sepse nëse do e kishte gjetur Faraoni apo ushtarët e tij do e kishin therur menjëherë, siç bënin me fëmijët e tjerë.

Asija, duke qenë se vetë nuk linte fëmijë i kërkoi atij që ta linte gjallë dhe ta adoptonin si fëmijën e tyre. Në Kur'an thuhet:

“Gruaja e faraonit i tha atij (faraonit): ‘Ky djalë është gëzim për mua dhe ty, prandaj mos e vrisni, sepse mund të jetë i dobishëm ose mund ta birësojmë. Por, ata nuk e dinin se çfarë po bënin.’” (Kasas: 9)

Dhe me të vërtetë Musai do të jetë burim gëzimi për Asijen e sinqertë, e cila kishte natyrë të pastër, mendje të shëndoshë dhe një zemër të mëshirshme.

Kur Musai u shpall profet, Asija së bashku me disa të tjerë besuan në mesazhin e tij, por e mbajtën të fshehtë për një kohë.

Asija edhe pse ishte mbretëresha e Egjiptit, edhe pse jetonte në pallate luksoze dhe i shërbenin me qindra skllave, zgjodhi Zotin dhe refuzoi gjithçka tjetër. Ajo ishte e vetëdijshme për çmimin që do të paguante për vendosmërinë e saj, për besimin në Zot, për pasojat e këtij vendimi, i cili do do ta çonte në humbjen e famës si dhe përjetimin e torturave të tmerrshme nga bashkëshorti i saj. Por, dashuria e saj për Zotin ishte mahnitëse dhe e pakufishme. Kur paraqitet kjo dashuri në zemër, çdo gjë tjetër është e parëndësishme. Fuqia e besimit dhe dashuria për Allahun mund të jetë aq e madhe sa që nuk ekziston fuqi në botë që ta thyejë dhe nënshtrojë atë. Kur Faraoni mësoi se gruaja e tij besonte në një Zot të vetëm nuk kishte katastrofë dhe fatkeqësi më të madhe për të dhe gati sa nuk u çmend nga tërbimi. Në shumë transmetime thuhet

se Faraoni e keqtrajtoi të shoqen dhe e torturoi atë çnjerëzisht me torturat më të ashpra në mënyrë që ajo të kthehej si më parë, por kjo nuk ndryshoi asgjë në besimin e Asijes, e cila duroi dhimbjet e torturave për hir të Allahut të madhëruar.

Kur Faraoni e pa gruan e tij aq të vendosur, durimi i tij u sos dhe urdhëroi që të lidhej në këmbë e duar në katër pika e të rrihej me kamzhik. Gjatë torturave Asija iu lut Zotit të saj që ta shpëtonte nga Faraoni dhe puna e tij dhe refuzoi pallatet e kësaj bote dhe i kërkoi Zotit një shtëpi në xhenet. Ajo nuk kërkonte vetëm një shtëpi, por e kërkonte atë pranë Zotit në Firdeusin e lartë. *“O Zoti im! Ndërtomë një shtëpi tek Ti në xhenet, më shpëto nga faraoni dhe veprat e tij dhe më shpëto nga populli keqbërës.”* (Tahrim: 11) Kur Asija po torturohej dhe tha lutjen e saj, qielli u hap për të dhe ajo pa shtëpinë e saj në Parajsë dhe buzëqeshi. Rojat u habitën se si mund të buzëqeshte kur po torturohej. I tërbuar Faraoni urdhëroi që të sillnin një gur shumë të madh që t’ia hidhnin përsipër që ta vrisnin. Por Allahu i Lartmadhërisëm ia mori shpirtin Asijes përpara se të sillnin gurin dhe e bëri shembull për të gjithë besimtarët burra dhe gra deri në fund të kësaj bote. Ai iu përgjigj thirrjes së Asijes duke bërë që shpirti i saj të ngjitet lart nën hijen që i bënin ëngjëjt për shkak të besimit dhe vuajtjeve që pati.

Madhështia e kësaj gruaje qëndron tek fakti se bukuritë e kësaj bote nuk e mashtruan dhe se qëndrimi dhe durimi i saj përballë torturave, ia shtuan vlerat dhe e rradhiten ndër katër zonjat e përsosura.

Thotë Profeti (paqja e Zotit qoftë mbi të) në një hadith: “Shumë nga burrat e kanë arritur përsosmërinë, ndërsa nga gratë, nuk e ka arritur këtë gradë veçse katër: Merjemja, vajza e Imranit; Asija, bashkëshortja e Faraonit; Hatixhja, vajza e Huvejlidit dhe Fatimja vajza e Muhammedit.” (Buhariu)

Jeta e Fatimes

Fatimja është vajza e Profetit Muhamed (paqja e Zotit qoftë mbi të) dhe e Hadixhes. Ajo lindi në vitin kur po rindërtohej Qabja, pesë vjet para profecisë së babait të saj, kur ai ishte 35 vjeç. Ajo u quajt Fatime, sepse Allahu e ruajti atë nga zjarri. Emri i saj rrjedh nga fjala arabe "fitam" që ka kuptimin "personi që është i ruajtur nga e keqja dhe karakteri i keq".

Ajo kishte disa epitete të tjera që i mori nga sahabët (shokët e Profetit) dhe më vonë edhe nga dijetarët e islamit. Ndër to është për t'u veçuar nofka "Zahra". Kjo pasi kishte dashuri të madhe ndaj Profetit (paqja e Zotit qoftë mbi të) dhe i ngjante shumë atij. Aishja thotë për të: "Nuk kam parë njeri prej krijesave të Allahut që ti ngjajë më shumë profetit në të folur dhe në të ecur se sa Fatimja".

Pjekuria dhe durimi ishin pjesë të karakterit të saj. Kjo shihet në përballjen me shumë sprova dhe ngjarje të mëdha.

Ndër to mund të përmendim: vdekjen e nënës së saj kur ishte vetëm 10 vjeçe dhe fjalët e saj ku shprehej: "Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi! O Allah, nuk e di se a duhet të jem e mërzhitur për vdekjen e nënës sime apo duhet të jem e gëzuar duke pasur parasysh se asaj i janë dhënë lajme të kënaqshme për në xhenet".

Pak çaste para vdekjes së Hatixhes erdhi Xhibrili dhe tha: "O Muhamed, përgëzoje Hatixhen me një vend në xhenet..."

Ajo shpeshherë e shihte babain e saj të goditur dhe të lënduar si në rastin kur njëri prej idhujtarëve kurejshit i hodhi zorrët e një kafshe të ngordhur në shpinën e tij ndërsa ishte në

sexhde. Ai qëndroi në këtë gjendje derisa erdhi Fatimja dhe ia hoqi prej trupit dhe sytë i kishte të mbushur me lot. Profeti (paqja e Zotit qoftë mbi të), e pa që po qante dhe i tha: "Mos qaj, o bija ime, se me të vërtetë Allahu do ta bëjë fitimtar babain tënd."

Fatimja, gjithashtu ishte dëshmitare kur të dy prindërit u izoluan në bojkotin që kurejshët ushtruan mbi myslimanët gjatë së cilit vdiq dhe Hatixhja dhe Ebu Talibi. Ajo ishte njëra ndër ata që e përcollën Profetin (paqja e Zotit qoftë mbi të) nga fillimi i shpalljes derisa ndërroi jetë.

Ishte vetëm pesë vjeçe dhe kishte shprehur dëshirën për të qenë myslimane e për të ndihmuar babain e saj në çdo hap të tij. Ajo e shoqëronte Profetin në çdo vend që i shkonte dhe për këtë arsye, kur lexojmë jetën e Profetit Muhammed (paqja e Zotit qoftë mbi të), e gjejmë shpesh emrin e Fatimes si mbrojtëse dhe shoqëruese në rastet kur ishte në rrezik.


Fatimja emigroi në Medinë kur ishte 18 vjeçe, një vit pas emigrimit të myslimanëve.

Kur u stabilizuan punët, njerëzit fillun të vijnë tek i dërguari i Allahut për të kërkuar dorën e Fatimes dhe për t'u miqësuar familjarisht me Profetin.

Mirëpo Pejgameberi (paqja e Zotit qoftë mbi të) u jepte përgjigje negative në mënyrë të sjelleshme.


Me pas, ishte Aliu djali i Ebu Talibit që kërkoi dorën e Fatimes dhe Profeti (paqja e Zotit qoftë mbi të) pranoi.

Profeti u lut në shtëpinë e te sapomartuarve me këto fjalë "O Allah, jepu begati këtyre të dyve dhe jepu begati në pasardhësit e tyre dhe bashkoi me të mirë".



Pas një viti Allahu i dhuroi Fatimes djalin e parë Hasanin dhe më pas Hysenin.

Familja e Aliut ishin njerëzit më të dashur të Profetit (paqja e Zotit qoftë mbi të). Kur zbriti ajeti kur'anor në suren Ali Imran:



“Thuaj ejani të thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, në veten tonë dhe ju vetet e tuaja pastaj të falemi e të lutemi dhe ta lëmë mallkimin e Allahut mbi gënjeshtarët, (Ali Imran 61). Profeti (paqja e Zotit qoftë mbi të) thirri Aliun, Fatimen, Hasanin e Hysejnin dhe tha: “O Allah, këta janë familja ime” (Muslimi).

Gjithashtu, Profeti (paqja e Zotit qoftë mbi të), bënë të ditur se ajo “Fatimja” ishte njëra prej grave më të mira të botës, ku thotë: “Gratë më të mira të botës janë katër, Merjemi, Asija, Hatixhja dhe Fatimja”.

Çdo herë kur Fatimja hynte në dhomën e Profetit (paqja e Zotit qoftë mbi të), ai ngrihej për të, e puthte në ballë dhe e ulte pranë vetes. Nëse Profeti (paqja e Zotit qoftë mbi të), shkante në ndonjë udhëtim, puna e parë që bënte kur kthehej ishte falja e dy rekateve

në xhami pastaj vizitonte vajzën e tij Fatimen (Zoti qoftë i kënaqur prej saj). Nga e gjithë çfarë u tha konkludohet, se ajo ka qenë shumë e rëndësishme tek Profeti (paqja e Zotit qoftë mbi të). Fundi i jetës së saj ishte shumë i vështirë. Ajo hyri në shtëpinë e Profetit u ul pranë tij, ai i tregoi diçka që e bëri Fatimen të qajë dhe të buzëqeshë. Kur profeti (paqja e Zotit qoftë mbi të), vdiq Aishja e pyeti për fjalët që ai i kishte thënë. Ajo tha: Herën e parë babai më tha: “O Fatime, Xhibrili çdo vit e ballafaqonte Kur'anin me mua një herë, ndërsa këtë vit e ballafaqoi dy herë. Nuk shoh tjetër veçse vdekja më është afruar.” Kështu unë qava. Kur më pa në atë gjendje më tha: “Ti je e para nga familja ime që do të më ndjekësh dhe ti do të jesh zonja e grave të xhenetit.” Kështu që unë qesha.

Ajo vdiq 6 muaj pas Profetit (paqja e Zotit qoftë mbi të), ashtu siç i kishte premtuar dhe u varros në Baki, ditën e martë të vitit 11 Hixhri.

Kjo pra, ishte jeta e Fatimes së pastër, durimtare, vajzës së Profetit Muhamed (paqja e Zotit qoftë mbi të), gruaja e Aliut, nëna e Hasanit dhe e Hysejnit, zonja e grave të xhenetit.



Letër motrës sime..!

Meemrine Allahut poeniskëtë letër duke lutur Krijusin e botërave që të jeni mirë meshëndet, punë dhe më rëndësishme jati jeni mirë me besimin sepse ky besim është shkaku që unë po ju shkruaj.

Në besimin e monoteizimit ne jemi vëllezër e motra dhe unë vëllai juaj po po ju shkruaj:

E vërtetë që nuk njihemi dhe nuk jemi takuar ndonjë herë, por na kalidhur litari i fortë i kësaj feje, mesazhi ynë "Lail-laheilla-Allah, Muhamed resulullah (nukka të adhuruar me të drejtë për veç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Tij). Në këtë lidhje më kushto pak kohë për të lexuar këto rreshta motër!

Jemi në prag të pushimeve verore, në prag të pushimeve të një viti të lodhshëm të zhurmshëm me plot stresse e mundime, me plot halle e probleme.

Nukkadyshimqëpushimenukdotëthotëqëmbaruanhalleteproblemetapostresete mundimet jo na presin të tjera sfida përpara.

Ndoshtakenikaluar njëvittëvështirëekonomik,tëprekurngakrizaglobaleaponjëvit akademikshkollorqëpoprisnisekudotëpozicionoheninëstudimetëtjeraaponënjë vënd pune.

Mundtëketëqenëvitiiparëimartesesapondoshtavitikujenindjerënenëpërherëtë parë apo dhe shumë të tjera.

Por,ndoshtamundtëketëqenëdhenjëvitisuksesshëmnëaktivitetetatuatëndryshmee sidoqëtëkenëqenë,kenevojëpërtëpushuardisaditënëkëtësezontënxehtëtëverës. Besoj se çdokush nga ju o motër ka përgatitur diçka për këto ditë pushimi.

Dëshirojt'jukujojtosejuvërtetëgjatëkëtyrepushimevenukdopushonidhengatëushqyerit, porpërkundrazidotëmundohenitëushqeheniedhemëmirë,portëkujtojsenjeriusiçka nevojë që të ushqejë trupin duhet të ushqejë edhe zemrën.

Mos harro dhe shpirtin, ushqimin e shpirtit!

1...mundohutëzgjedheshvendinepushimevepërtrupintëndqëtëjetëdhevendqetësimi dhe ushqimi për shpirtin.

Satëkeshmundësit'ilargoheshvendevekunukpërmendetAllahudhenukrespektohen simboleteTij,portëgjeshvendekumundtëfitonikohëngëtëmeditoninëkrijesateZotit, tëholumtoninëvetettuaja,tëkthehenitekvlerealeqëtëjepkjo fepërnjëshpirttë pastër e të shëndoshë.

- Le të jetë Kur'ani, libri kryesor në duart tuaja gjatë këtyre pushimeve;

-Namazi në kohën e vet të jetë miku më i mirë gjatë këtyre ditëve;

-PërmendjaeAllahutmelutjedhekërkimiifaljestëjetëprejushqimitbazëtëshpirtitme shumë se çdo ditë tjetër në këto ditë të nxehta vere.

2Mundohutaprogramoshkohënepushimevetëatillëqëtëkeshmundësitëjeshidobishëm për familjen dhe shoqërinë.

Nërradhëtëparëtefamiljajuajdukezgjedhurprogrametmëtëbukuraedukusepër fëmijëtuajdukeerregjistruarnëkampingjeveroreedukueseislame,dukeiblerëlibrame histori e të tjera të përshtatshme.

Gjithashtunëkëtëkujdespërfamiljenmosharrosenësevitiqëkaloinukmundtëishit pranënjërezvetëdashurtëfisitnëkëtoditëprogramokohëngët'ivizitonitëgjithëtë afërmittuajsepseruajtjaelidhjevëfarefisnoreështëshkakqëjushtohetjetadhepasuria siçnakalajmëruaridërguariifundit,profetiMuhamed,paqjaemëshira eZotitqoftë mbi të.

3Mos harroni dhe shoqërinë të mos bëheni barrë për shoqërinë në pushimet tuaja qëdotëthotëmosuprishniqetësinëtëtjerëvenëpushimetetyreapodhenëpunënetyre gjatëkohësquëjujenimepushimeporduhettëjinitëdobishëmpërnjëzitetdhetushërbeni atyresepseprofetijonëthotë: Mëimiriinjërezveështëmëidobishmiityredhenënjë shprehje tjetër thotë: ai që i shërben një populli është zotëriu i tyre.

Kjorealizohetdukeraujturqetësinë,ambientindhedukeraujtur moralindheetikën islame që ke mësuar.

Këtoishinkëshillatqëdodëshirojat'jukujojtatëpërmbledhuradhejuurojngazemra pushime të mbara dhe të bereqetshme në këtë botë dhe në botën tjetër.

Me respekt vëllai juaj!



Femra, DREJT CIVILIZIMIT TË DENATYRIMIT

nga: Enkeleda Rroshi

A nuk po e shikoni se çfarë po ndodh?! Apo nuk e kuptoni se çfarë po bëjnë me ju? Si mund ta pranoni?!...Me sa duket, askush nuk është i prirur të dallojë dështimin e projekteve të një shoqërie e cila po bën çfarë të dojë me ju!

Në fillim të nxorri ty nga vatra familjare për të hedhur nëpër ara e nëpër kantiere, më pas të veshi ushtare dhe montatore dhe së fundi të zhveshi për të të shitur skllave. Ato të premtojnë barazinë dhe çlirimin nga autoriteti i burrit dhe të bëjnë sekretare dhe kamariere për burrat e tjerë, mjet pune për ta, e tani je tipari i shoqërive reklamuese. Tani ti zhvishesh për të reklamuar produktet konsumatore në çdo cep të vendit. T'i po harron që po shet dhe ekspozon trupin tënd sipas një sistemi të shpikur nga meshkujt, ambalazh joshës për t'u shitur atyre mallra, makinë luksoze me xhetona për qejfin mashkullor, e sa e sa të tjera. Tashmë ti je krijesë e degraduar dhe e abuzuar për qëllime tregu, kështu që nuk mund të pretendosh të jesh asgjë më tepër se një objekt kënaqësie për ata në çdo vend. Por t'i ke harruar se e gjithë kjo nuk do të zgjasë shumë. Ti do të jesh e

kërkuar vetëm në një pjesë të jetës tënde. Ata të morën e ta shkatërruan rininë, bukurinë, pastërtinë, pafajësinë, gjithçka dhe tani që t'i po plakesh, tani që bukuria po të venitet, tani që nuk ke më se çfarë të shesësh e çfarë të shërbesh në treg, shoqëria, individët dhe institucionet të braktisin dhe të lënë të harruar e pa vlera, të jetosh vetëm në shtëpinë e braktisur, në rrugë apo në ndonjë spital pse jo psikiatrik. Tani një tjetër gonxheje po ia thithin aromën e saj të pastër, aty ku dikur ishte ti. Po dhe sa të tjera do të vyshken kështu, ende pa çelur mirë? Dhe sa do të durojmë? E sa do të lejojmë? Por "ata dinë se ku të peshkojnë"! Ata të rrëzuan nga vendi i shenjtë prej nëne ku të lartësoi Zoti dhe për të të bërë më të frytshme për industrinë dhe tregun, të ndërhyjnë në trup duke të shkukur fëmijët me aborte e duke të montuar në bark teknologji dhe çarqe kundër fëmijëve, diafragmat e spiralet



për të parandaluar amësinë. Të tjera ndërhyjnë në krijimin e Krijuesit të vetëm me kirurgji plastike për të ndryshuar format e përmasat e tyre, për t'u dukur "perfekshmërisht të bukura", por a ka mangësi në krijimin e Tij? Ai që krijoi çdo gjë me përsosmëri? A nuk po mendon?! Gjithçka vërtitet rreth denatyrimit e diskriminimit të bukurisë femërore, që tashmë bota maskiliste nuk vlerëson tek ajo vlerat e saj, inteligjencën apo zgjuarsinë. Po ku po shkojnë kështu? Guxojnë të ndryshojnë edhe gjininë? E kjo qenka kulmi i civilizimit, pa harruar edhe martesën mbrenda së njëjtës gjini! O Zoti ynë, na ruaj nga zëmërimi dhe dënimi yt!

Kjo është e vërteta e rëndë që nxjerr kokën përtej maskës së civilizimit. Një e vërtetë për t'u parë nga ata që nuk kanë sy sepse kush di të shohë e ka dalluar denatyrimin edhe përtej civilizimit. Është ky civilizim që e

bën femrën të jetë e pambrojtur, e friksuar, e diskriminuar e të lënë më një anë kur rinia humbet, e jo vetëm kaq.

Nëse ky civilizim është i mjaftueshëm si mbrojtje, atëherë pse femrat duhet të stërmundohen kaq shumë për t'i përngjasuar "kukullës Barbi", pse duhet të mbajë një dietë aq të fortë sa të dëmtojë shëndetin e saj, përse i duhet të trukohet aq rëndë për të qenë në qendër të vëmendjes, përse u duhet të vishen aq të zhveshura në rrugë, ...?!

-Për të zënë një vend pune? Për t'u mbajtur në punë? Për të tërhequr vëmendjen, që të tjerët të kthejnë kokën kur parakalon? Për të patur më shumë shokë? Për t'u shkolluar? E sa, e se të tjera. Për çfarë atëherë na shërben kjo mbrojtje civilizuese, që në fakt është kaq diskriminuese e maskiliste, e cila çoi në këtë "revolucion femëror"! Ku është e drejta dhe liria ime?! Nëse nuk kam këto gjëra që shoqëria m'i përplas në fytyrë atëherë unë çfarë të bëj me to? Ndaj t'i medito mbi atë se çfarë Zoti i Madh të ka dhënë, mbi atë që të ka lejuar e mbi atë që të ka ndaluar, se nuk ka dyshim se ato janë më të mira për ty dhe për mbarë njerëzimin.

Nëse edukimi që ata e mendojnë zgjidhje, pse atëherë në shumë vende të botës ekzistojnë kolegje për gjini të ndara? Nëse vetëkontrolli apo vetëpërmbytja qenka zgjidhje, atëherë përveç vendeve të ndryshme nëpër botë, edhe këtu tek ne nëpër vende të ndryshme të punës ka imoralitet e dhunime? Pse, pra, ky i ashtuquajtur civilizim nuk po arrin t'i civilizojë të degjeneruarit, të cilët i cënojnë të drejtën për të qenë të lira gratë dhe vajzat në rrugë, në punë, në shkollë e vende të tjera? Ndoshta do të na përgjigjet ndonjë duke thënë se, ato janë vetë fajtores sepse vetë po fillojnë, ato të parat me lakuriqësinë e tyre. Një gjë duhet ta kemi shumë të qartë, nëse të rinjtë vazhdojnë me këto trende "emancipuese", atëherë femra do të jetë ajo që do ta paguajë çmimin më të shtrenjtë. Nuk do të jetë dorë që përkund djepin e botës, por do të jetë bombë që sjell shkatërrimin e saj. Ndaj mendo, arsyeto, lutju Zotit të të udhëzojë, të të ruajë nga ky "civilizim" i shfrenuar.

E pra, ti mos i dëgjo pasuesit e së kotës që thonë: "Mbulesa është burg, ndalesë, shkelje e të drejtave... deri në fund të këtyre shprehjeve të kota, sepse Zoti nuk ka urdhëruar që mbulesa të jetë burg, apo ndalesë ose shkelje e të drejtave, por e ka bërë mbulesën mburojë, dritë, nder, paqe dhe mbikqyrje për femrën myslimane, kudo që ajo të jetë.

PËRRETH NJË BOSHTI

KONFLIKTET PRINDËR-FËMIJË

nga: ORIOLA HETA (Varosi)



Është i dhunshëm.....si të sillen me të?

Konfliktet me prindërit janë të shpeshta. Ato shkaktohen nga konfuzioni i roleve midis prindërve dhe fëmijëve. Ja disa këshilla praktike, si të silleni në një rast të tillë:

Ruaj qetësinë. Ju nuk duhet të frikësoheni nga sjellja e fëmijës suaj.

Dënoni çdo veprim të dhunshëm pa përjashtim. Autoriteti është mbi të gjitha një çështje qëndrueshmërie. Nëse ju pranoni, qoftë edhe një herë që të ngrenë duart e tyre kundër jush, ky gjest me siguri që do të përsëritet. Mos ndryshoni asnjëherë qëndrim: askush në familje nuk duhet goditur në momente nervozizmi... të gjithë duhen respektuar, një sjellje që fëmija duhet ta mësojë mirë.

Shërbeji si shembull. Ju jeni një model i mirë për t'i mësuar fëmijës suaj rregullat e jetës. Në qoftë se ju flisni në mënyrë agresive, në qoftë se ju ushtroni dhunë mbi të, të jeni të sigurt që ai do të bëjë të njëjtën gjë.

Është xheloz për motrën/vëllanë ...si të sillen me të??

Xhelozia është ndjenjë natyrore. Ne jemi të gjithë xhelozë, - thotë psikologja Michele Tallandier. Është detyrë e prindërve të minimizojnë këtë ndjenjë dhe të respektojnë diversitetin e

gjithësecilit. Disa këshilla praktike për këtë situatë:

Lejojeni fëmijën tuaj të përjetojë emocione negative.

Ndihmoje fëmijën tënd të shprehë emocionet e tij negative. Vetëm kështu ju do të jeni në gjendje ta ndihmoni atë në mirëmenaxhimin e këtyre emocioneve.

Plotësoni nevojat e tij më të rëndësishme: Edhe të rriturit kanë nevojë për vëmendje. Në këtë pikë nevoja e tij është plotësisht e justifikuar. Me ardhjen në jetë të një fëmije tjetër ai do të ndihet i lënë pas dore. Dil shëftitje vetëm me fëmijën tënd dhe bisedo për gjëra që atij i interesojnë, vlerësoje dhe motivoje atë, duke i rikujtuar disa herë që ju e doni si më parë ndoshta më shumë. Kujdes! Nëse, pavarësisht nga përpjekjet tuaja, fëmija është i dhunshëm ose agresiv ndaj vëllait/motrës së porsalindur, kërkoni ndihmë nga një specialist.

Mos lër pas dorë mos animin te njëri prej tyre, që të mos vihet re e të bëhen xhelozë për shkak se ju anoni.

Nervozohet shpejtsi të sillen me të?

Psikologja Michele Tallandier shpjegon se nervozizmi është gjithmonë tregues i një gjendjeje jo të mirë të fëmijës, tregon se ai ka vështirësi të mëdha në përshtatje dhe komunikim me pjestarët e tjerë të familjes. Pamundësi për të reaguar në

situata të ndryshme, revoltë, ankth, britma janë disa forma të shprehjes së kësaj gjendjeje: fëmija e shpreh nervozizmin duke mos kontrolluar më emocionet e veta, duke reaguar në mënyra të dhunshme.

Fëmija juaj ka humbur kontrollin.

Prit pak sa të qetësohet situata dhe këtë gjë bëje duke qëndruar indiferent ndaj sjelljes së tij ose duke e izoluar si sjellje.

Mos reago edhe ti në të njëjtën mënyrë të dhunshme. Sjellja juaj është një shembull për të.

Qetëso fëmijën duke e përqaftuar atë. Kjo nuk do të thotë që ju duhet ta përkëdhelni, por të mbani nën kontroll nervozizmin e tij/ e saj. Duke reaguar në këtë mënyrë do t'i tregoni fëmijës që nervozizmi i tij nuk ju tremb.

Kur të jetë qetësuar. Flisni së bashku për atë që ndodhi, duke evituar të përfshini një person të tretë në këtë situatë (p.sh. babain).

Shpjegoni si ndjehesh. E teprove! dhe pse të nervozohesh është mëse normale, ndjenjë të cilën e përjetojnë të gjithë, mua më vure vërtet në vështirësi dhe më bëre të ndjehem keq.

Ti prind, mos harro edukimin për të qenë i qetë më pas.

Ka gënjersi të sillem me të?

Gënjeshtër dhe emocione.

Gënjeshtër nuk ka të njëjtin kuptim si për të rriturit edhe për fëmijët, por nuk duhen mësuar me të edhe pse shumë pediatër të ndryshëm thonë: "Pothuajse të gjithë fëmijët gënjejnë. Një imagjinatë e gjallë është tregues i një shëndeti të mirë mendor".

Imagjinata dhe realiteti. Kufiri midis reales dhe imagjinatës është shumë i paqartë për fëmijën, i cili shpesh dëshirat e tij i shikon si pjesë të realitetit. Gënjeshtër shpesh herë mund të shikohet si një ide që vjen e nxitur nga imagjinata.

Si të sillem me të?

Fillo bisedën me frazën "mos gënje asnjëherë". Nëse ju shtrembëroni realitetin ose nuk mbani premtimet e bëra, fëmija juaj do të ndjekë shembullin tuaj. Mos bëj pyetje të cilat janë poshtëruese për fëmijën dhe e bëjnë atë të ndjehet keq, mos e dhuno atë në emër të së

vërtetës dhe logjikës. Gjyko më shumë qëllimin sesa veprimin në vetvete: Çfarë donte të thonte, Çfarë do të tregonte fëmija juaj duke u sjellë në këtë mënyrë? Përse nuk tregoi të vërtetën? Ndoshta ndonjëherë përgjigjen do ta gjejmë tek vetja.... në mënyrën se si komunikojmë me ta. Mësoje se Zoti zemërohet me gënjeshtërën dhe se duke gënjer babi dhe mami nuk të duan.

FAZA E "JO-së"

Fëmija juaj nuk është rritur akoma. Procesi i rritjes kalon nëpër disa faza të cilat shpesh herë janë edhe kontradiktore me njëra - tjetrën. Faza e "jo-se" që fillon rreth muajit të 18 (dhe mund të vazhdojë deri në moshën 3 vjeçare) është një periudhë e rëndësishme për zhvillimin e fëmijës: në këtë kohë fëmija fillon të kuptojë, kërkojë pavarësi, ai kundërshton pothuajse për çdo gjë. Edhe pse kjo fazë mund të jetë e vështirë dhe e lodhshme, përsëri mbetet shumë e rëndësishme. Prindër përdorni çdo mënyrë për të kapërcyer këtë moment dhe mos harroni asnjëherë se është detyra juaj ti mësoni fëmijëve rregullat e jetës.

Kërkon që ti blihet cdo gjë që shikon... si të sillem?!

Të parandalosh është më mirë se sa të kurosh. Ndodh shpesh që kur dilni për pazar fëmijët të fillojnë të kërkojnë që t'i bleh çdo gjë që shikojnë, gjë e cila na vë në vështirësi. Për të shmangur një situatë të tillë, para se të dilni tregoi fëmijës se cilat janë gjërat që do të blini për të dhe për vete. Përdor fantazinë. Në supermarketet e mëdha ka reparte të cilat kanë mallra për fëmijë. Gjej dhe përdor alternativa për të shpërqëndruar fëmijën tuaj. Psh kërkoj atij të të ndihmojë të gjeni shishen e qumështit që përdorni ose biskotat që vetë fëmija pëlqen d.m.th përfshijeni edhe fëmijën tuaj në bërjen e pazarit. Kërkoj të të ndihmojë. Në këtë mënyrë, fëmija do të ndjehet i përgjegjshëm dhe ju do ta mbani nën kontroll. Kërkoj të të ndihmojë psh. të sistemoni së bashku ushqimet në karrocë, të të lexojë çmimet apo t'i krahasojë ato.



Autoriteti nuk nenkupton domosdoshmerisht ndeshkimin

Autoriteti sinonim i të mësuarit. Të përdorësh autoritetin nuk do të thotë të ndëshkosh, por të drejtosh, autoriteti shpesh është pjesë e dialogut: është detyrë e prindërve t'i tregojë, shpjegojë fëmijëve rregullat e jetës, rreziqet dhe të mirat e saj. Por mund të ndodhë që në një moment krize të mos ketë komunikim, çfarë duhet të bëjmë??? Secili rolin e tij. Fëmija juaj ka humbur çdo kontroll dhe ti je e shqetësuar... kujtoji atij që janë prindërit të cilët vendosin rregullat; mos harro rolin që ka secili në familje. Ju jeni të rritur dhe mund ta kontrolloni më mirë se fëmijët nervozizmin. Në momente nervozizmi largohu fizikisht për disa çaste nga fëmija: gjë e cila do të të ndihmojë të largohesh nga problemi dhe të qetësohesh për tu rikthyer më e qetë dhe e qartë.

Autoritet pa përdorur dhunë. Mos harro asnjëherë je shembulli i sjelljes së fëmijës, ndaj nga nervozizmi nuk duhet të gjenerojë dhunë dhe poshtërim. Kur situata është e rëndë, qëndroi përballë dhe në të njëjtën gjatësi me të duke e parë në sy, kujto se është më i vogël se ty.

Nuk regullon asnjëherë dhomën e tij / e saj...

Fëmija dëshiron të luajë lirshëm: Fëmijët e vegjël nuk e kanë të qartë idenë e rregullit dhe rrëmujës, por mund të mësohen gradualisht me ndenjen e rregullsisë. Për të realizuar këtë gjë mund t'i kërkosh fëmijës të të ndihmojë të mbliidni së bashku lodrat dhe t'i vini në vënd. Por kujdes fëmijës i duhet kohë që të mësohet me këtë gjë! Mos harro ata kanë nevojë për lëvizje të lirë që të zhvillojnë fantazinë e tyre, që të rriten të shëndetshëm. Përparësitë e rregullit.

Shpjegoi se cilat janë përparësitë e rregullit: lodrat e tij të preferuara do të zgjasin më shumë nëse kujdesemi për

to...- kërko mendimin e fëmijës para se të hedhësh lodra të tij ose të bësh ndryshime në dhomën e tij të gjumit.

Të dish të thuash - jo

"Një fëmijë pa kufij nuk është as i lirë as i lumtur, ai jeton nën ankth, është viktimë i instikteve të tij" shkruan psikologja franceze Claude Halmos.

Ndaj kufinj të janë të rëndësishëm për zhvillimin e një fëmije, ato i japin siguri atij. Është detyrë e juaja t'i mësoni fëmijës kufinj të që ai të ndjehet i sigurtë. Në këtë mënyrë ai do të jetë në gjëndje të:

Të pozicionohet më mirë kundrejt teje dhe pjesëtareve të tjerë të familjes. Të respektojë intimitetin e tij. Mësoje të të respektojë ty dhe babain.

Të kuptojë që bota nuk është një xhungël, por në të egzistojnë rregullat dhe ligjet. Nuk mund të bësh çdo gjë që dëshiron dhe në çdo vend: gabimet ndëshkohen kudo.

Teddy Brazelton pediatre ka shkruar disa keshilla lidhur me atë që quhet "disiplina pozitive"

Kujdesu që disiplina që do të përdorësh të jetë në përputhje me zhvillimin e tij.

Disiplina duhet të jetë në përputhje të plotë me personalitetin e fëmijës. Një fëmijë shumë i ndjeshëm rrezikon të përjetojë trauma për shkak të një ndeshkimi i cili mund të jetë i efektiv tek një tjetër fëmijë i cili ka një personalitet më të fortë.

Pas përfundimit të krizës, shpjegoi fëmijës tënd arsyet se përse nuk duhet të bëhet viktimit e impulseve të tij.

Shprehi dashurinë e madhe që ke për të, pas përfundimit të krizës me fjalë të thjeshta "të dua shumë por nuk është mirë të sillesh në këtë mënyrë".

Në fund mos hezito ta komplimentosh, nëse arrini që së bashku të dilni nga kriza mos harro të thuash "bravo!" isha e sigurtë që ti do ta zgjidhje këtë krizë.

Fëmija është një qenie njerëzore e pafajshme dhe e pastër. Këtë e dimë të gjithë por, jo të gjithë e dinë mënyrën se si ta njohin atë.

Duke lindur pa asnjë lloj vesi e plot vrytje, e kjo nga natyrshmëria e pastër e tij, duhet të na bëjë më të vetëdijshëm e duhet patur kujdes me to.

Jemi mësuar ta quajmë problemin e edukimit të fëmijëve shumë të vështirë, shqetësues e të paarritshëm, por vërtet është një betejë shumë vendimtare për ecurinë e tij në jetë.

Kur kjo botë evoluon me hapa gjigandë dhe zhvillimi i teknologjisë ka ngacmuar njerëzimin që të arrijë zhvillim të lartë intelektual, këtë zhvillim nuk e përthith dot një fëmijë i moshës 3-6 vjeç, i cili nuk është edukuar mirë me të nxëniet dhe të sjellurit. Kjo botë kaq e zhvilluar nuk paska mundësi dhe aftësi edukuese në nivelin e duhur për brezat pasues?

Ajo për të cilën nuk do kishte pushuar së zbuluari gjëra që bëjnë çudinë, do ishte zbulimi i asaj çfarë do rregullonte më së miri kujdesin dhe mirënjohjen e fëmijëve nga ana e prindërve.

Dhe padyshim kjo është dhe duhet të jetë çdo gjë që çon në punën e papërtueshme dhe këmbëngulëse të njerëzimit. Kur themi: të njerëzimit" e themi në kuptimin e "prindërve" sot, dhe jo vetëm njëri por së bashku që të dy. Prindërit e kanë detyrim ta rrisin fëmijën e tyre me plot vrytje të larta e moral të mirë, me durim dhe mirësi, gjithnjë dominues nga pozitivja.



DEDIKIM

Si ta njoh fëmijën 3-6 vjeç?

nga: Haxhere Jaho

Kur një psikologu italian i dhanë një fëmijë 3 vjeç për ta edukuar, ai e mori fëmijën për ta testuar, dhe e pa me vëmendje gjendjen e tij në kohën e lirë, kur luante, në momente kritike, e në çdo drejtim. Psikologu pa tek fëmija veprime jo të mira dhe arriti në përfundimin se ai nuk ishte edukuar mirë.

Psikologu vazhdoi duke thënë: - Është shumë më e lehtë të edukosh se sa të riedukosh.

E me pak fjalë, kuptojmë, se ai deshi të thoshte se edukimi fillon shumë e shumë më heret, pa përmendur aforizmën e njohur, të paktën që nga mosha zero vjeç. Nënata mund të çuditën kur të lexojnë 0 vjeç, por ju nëna jeni edukatoret e para, më pas vijnë edukatoret e çerdheve dhe të kopshtit dhe ju ju bie më pas të jeni edukatore të veprimeve të mira ose të gabuara. Ju e lindni fëmijën, e mbani, e ushqeni, e lani, i flisni që kur ai belbëzon, ja pra, jeni ju dhe ju.

Ju e përkëdhelni, ju keni kohën më të gjatë me të dhe juve ju takon pikënisja e edukimit.

Natyrisht tek edukimi më pas janë një sërë faktorësh, por jo larg janë edhe pjestarët e familjes. Thuhet se nëna e edukon fëmijën 80% dhe se babai 20% dhe kjo duke mos nënvlerësuar pjestarët e tjerë të familjes siç mund të jenë gjyshi dhe gjyshja.

Kur lind fëmija, truri i tij është bosh, por ai fillon të mbushet me atë çfarë dëgjon dhe ndjen, prek dhe shijon.

Lind pyetja: Kur themi se nëna e edukon më së miri, ajo duhet ta edukojë me ndonjë leksion apo me veprime që ajo i sheh ose jo si spontane apo të përcaktuara?

Jo, fëmija nuk ka shumë nevojë të mësojë shumë leksione. Ai është tepër imitues. Ai ka aftësinë e një kompjuteri.

Nëse ju do të shkruanit në kompjuter atë që do dëshironit, edhe fëmijës po ashtu do i shkruanit, sepse ai është shumë i shpejtë në marrje dhe në perceptim (parë kjo nga ana figurative).

Nëse ju nëna në ambiente publike ose në shtëpi do të flisnit me zë të lartë, edhe fëmija juaj kur të rritet ashtu do të flasë. Padyshim edhe fëmija do të kryejë disa gjëra të pahijshme, nëse edhe ju më parë i keni kryer ato.

Është i njëjtë rezultati nëse ju si prindër do të sillleshit keq me pjestarët e tjerë të familjes dhe fëmija nesër kur të rritet do të sillet shumë keq me ju. Nëse komunikohet me ta ose edhe më pjestarët e tjerë të familjes së madhe me urrejtje edhe fëmijët nesër do flasin po me urrejtje dhe kjo do ju kthehet pikërisht ju, prindërve. Nëse bashkëshortit tënd nuk do i japësh vendin që i takon në familje, do ta injorosh, ofendosh, të gjitha këto i kthehen nënës.

Prindër, nëse ju do të mashtroni, apo gënjeni, do përbuzni të varfërin, do bëni dallime raciale etj., të gjitha këto i rimarrin fëmijët tuaj pa diskutim. Ju prindër duhet të bëni kujdes edhe me personin i cili ju mban fëmijën! Duhet ta njihni personin të cilit i lini në dorë fëmijën tuaj. Janë raste tepër të rralla ku shoqëria ka ndikuar më shumë se sa prindërit e fëmija është edukuar mirë.

Kini parasyh agronomin se si kujdeset për filizën e re, i shërben, e ujit e krasit, pra i jep asaj një drejtim siç do dhe sa mundet. Apo rasti i skulptorit, i cili formon pikturën apo skulpturën e tij ashtu si dëshiron, por ndryshe nga piktori që e bën dhe e prish sërish punën e tij ngase nuk i pëlqen, me fëmijët që i përpunojmë që të vegjël është vështirë t'i korrigjosh, nuk u jep më drejtimin e duhur kur kanë kaluar shumë kohë. Pra, është më mirë të ndërtohet se sa të rindërtohet, më mirë të edukosh se sa të riedukosh.

Një mesazh për ju!

Nëse ju keni marrë apo përfitur pa dashur vese të keqija, mundohuni t'i korrigjoni, jini më tolerant ndaj vetes, sepse çdo gjë kthehet po tek ju. Bëni kujdes ndaj fëmijëve tuaj sepse çfarë keni përgatitur ju për ta, do ju kthehet një ditë ju apo edhe shoqërisë ku jetojnë me të mirat apo të keqijat e tyre.

Hixhamja

Cupping therapy

nga: Armida Plumbi

Ç'është hixhamja?

Aplikimi i saj, rregullat dhe çdo detaj mbi të.

Hixhamja bën pjesë në fushën e mjekësisë alternative, mjekim me metodën profetike-shkencore që anglisht quhet "cupping therapy", heqja në pika specifike të trupit e gjakut të mpiksuar, i cili mund të sjellë shumë sëmundje në trup deri tek tumoret.

Meqë ndryshe nga degët tjera të mjekësisë alternative kjo veçohet sepse siguria e saj bazohet në origjinën e saj praktike hyjnore nga profeti Muhamed, i cili ishte i udhëzuar nga Zoti i madhërisëm ta rekomandonte për njerëzit, si metodë shumë e sigurt dhe e suksesshme në kurimin e shumë sëmundjeve njerëzore.

Kjo metodë mjekimi ose mjekësia profetike edhe pse është zbritur bashkë me mrekullitë e tjera nga Krijuesi i njerëzimit mijëra vjet më parë, është e pashoqe në trajtimin e sëmundjeve të ndryshme, por kjo metodë nuk është studiuar më parë nga shkencat mjekësore moderne.

Praktika e hixhames ka qënë pjesë e kulturës së Lindjes së Mesme për mijëra vite dhe daton që në kohën e Hipokratit. Ndërsa në Perëndim starton si metodë me ardhjen e kulturës së egjiptianëve të lashtë kur ata sollën në Evropë librat shkencorë mjekësorë të zhvillimit të tyre, si Ebers Papyrus, të shkruara afërsisht rreth vitit 1550 p.e.s.

Vetëm dy- tre dekada më parë, sidomos pas viteve 90, shkenca e mjekësisë po merret seriozisht me këtë metodë dhe është provuar në aspekte biokimike, fizike e fiziologjike për efektin madhështor kurues të mjekësisë profetike, e cila nuk duhet dyshuar asnjëherë ashtu sikurse nuk dyshohet në atë që ka krijuar njerëzit si dhe fuqinë kuruese të hixhames për ta.

Ç'është hixhamja

Hixhamja është mjet shërimi më i mirë i rekomanduar dhe i përdorur nga Profeti ku dhe thotë: *"Sa i mirë është shërimi me hixhama"*.

"Hixhama" si term rrjedh nga fjala arabe "haxhm" që do të thotë "të thithësh". Hixhama është procesi i vënies së disa kupave në pjesë të caktuara të trupit, duke i hequr ajrin nga brenda kupave për të krijuar një vakum.

Shpjegimi shkencor i hixhames

Cupping therapy ose hixhama është përdorur edhe në kuptimin për të hapur meridianët e trupit. Ç'janë meridianët?

Meridianët janë kanale në trupin tonë nëpër të cilat energjia kalon në trupin tonë tek çdo pjesë e trupit gjeri në organet dhe indet më të thella të tij. Kemi pesë meridianë në shpinë të cilët kur janë të hapur lejojnë të penetrojë dhe të udhëtojnë energjia në të gjithë gjatësinë e trupit. Është zbuluar që hixhama apo cupping është metoda e vetme, më e mira për hapjen e këtyre meridianëve të bllokuara. Gjithashtu është vërtetuar plotësisht që hixhama depërton deri në thellësinë 10 cm të trupit nga vendi i hixhames, duke shkaktuar kështu pastrimin e trupit nga toksinat e ndryshme, duke aktivizuar gjëndrat limfatike përgjegjëse për imunitetin, duke pastruar kolonin e bllokuar, aktivizon dhe pastron venat. Hixhama pastron njolla të ndryshme në lëkurë dhe mjekon venat varikoze pa tromboza. Cupping apo hixhama është metoda masazhuese më e mira deri më tani për indet e thella.

Metodat e aplikimit me kupa plastike është më modernja dhe kupat janë të shumëllojshme dhe praktike në përdorim.

Vendet ku kryhet hixhamja

1. Tek e buta e kokës (të cilën e kanë fëmijët të butë kur janë të vegjël).
2. Maja e kokës, aty ku bashkohet kocka e parme me kockën e mbrapme të kokës.
3. Në dy anët e qafës.
4. Ndërmejt shpatullave.
5. Në kurrizin e këmbëve.

**Vini re:* Këto vende janë si për burrat ashtu edhe për gratë.

Disa hadithe për vlerën e hixhames

1. Nga Enesi transmetohet se Profeti (paaja e Zotit qoftë mbi të) ka thënë: *"Kush dëshiron të bëjë hixhame le të kërkojë ditën e 17 ose 19 ose 21. Te mos e lejë njeriu t'i ndizet gjaku se po u ndez e vret njeriun"*. Ndezja e gjakut mund të jetë në disa raste si psh rastii tensionit të lartë. Transmeton Ibn Maxheh dhe e saktëson Albani nr. 2808.

2. Transmetohet nga Xhabiri r.a. se Profeti (paaja e Zotit qoftë mbi të) ka thënë: *"Hixhamja është shërimit"*.

3. Ka thënë Profeti: *"Hixhamja me barkun bosh është më e mirë."*

Ajo forcon mendjen dhe shton kujtesën".



Ndalesat e hixhames

Nuk ka asnjë ndalesë për përdorimin e hixhames, sepse profeti ka treguar se ajo është shërimit. Për këtë arsye ajo mund të kryhet për të gjitha moshat edhe për gratë shtatëzëna ose ato që u japin gji fëmijëve ose grave me menstruacione ose lehoni ose atyre që nuk kanë menstruacione e lehoni.

1. Nuk ka hadithe të sakta që tregojnë për kupat e thata. (d.m.th. pa prerje). Profeti ka treguar se shërimi është tek prerja e hixhames.
2. Nuk ka argumente të sakta që tregojnë se marrëdhëniet seksuale pas hixhames janë të dëmshme.
3. Nuk ka argumente që vërtetojnë se pirja e qumështit ose nënprodukteve të tij janë të dëmshme pas hixhames.
4. Nuk është e saktë se hixhamja në kohën e shtatëzanisë është e dëmshme.
5. Nuk është e saktë se dalja e gjakut të menstruacioneve dhe lehonisë mjaftojnë për gruan dhe nuk ka nevojë për hixhame.
6. Të gjitha vendet që treguam për hixhamen mund të kryhen tek pacienti njëherësh në të njëjtën ditë.
7. Mund të kryhet hixhamja në vende të tjera veç këtyre që u treguan në bazë të nevojës për të.

Mjekimi me hixhama

Hedhja e kupave (hixhami) nënkupton nxerrjen e gjakut të keq, i cili gjendet nën lëkurën e trupit të njeriut. Ky proces është një trajtim mjekësor. Është treguar nga Ibn Abbasi se i Dërguari i Zotit ka thënë: *"Shërimi është në tre gjëra: lëshimi i gjakut përmes prerjes së lëkurës pas hedhjes së kupave (hixhami), të ushqyerit me mjaltë dhe djegia e lëkurës për shërim (kauterizimi me zjarr), por djegjen e lëkurës (kauterizimin) ia ndaloj Ummetit tim"*. (Transmeton Buhariu). Terapia e kupave apo nxjerrja e gjakut (hixhami) është praktikë e miratuar nga i Dërguari i Zotit i cili edhe i paguante të tjerët për këtë masë terapeutike. Nxjerrja e gjakut të keq bëhet për shërimin e dhimbjes së kokës. Disa dijetarë pajtohen se kur njeriu bën vendosjen e kupave përderisa është duke agjëruar, e prish agjërimin edhe ai në të cilin është bërë hixhami, po ashtu e prish agjërimin edhe ai i cili merret e këtë proces (ai që iu bën të tjerëve). Kërkimet moderne kanë arritur kulmin në rezultatin se hedhja e kupave është njëra nga metodat më efektive dhe më e sigurtë terapeutike. Kjo është

provuar me efektshmëri tek shumë të sëmurë. Veç kësaj, ajo paraqet një mënyrë natyrale të trajtimit që ndryshon prej trajtimit mjekësor duke përdorur barna të ndryshme që ndoshta edhe çojnë edhe më në keqësimin e sëmundjes apo dhimbjes. I Dërguari i Zotit ka thënë: *"Është i bekuar ai rob i cili lëshon gjak me anë të prerjes së lëkurës. Kjo pastron gjakun, qetëson pezmatimet e brendshme dhe forcon të parit."* (Buhariu dhe Muslimi) Shkencëtarët kanë zbuluar se heqja e gjakut (flebotomia apo ventuza) mund të shërojë disa sëmundje të zemrës, probleme me gjak dhe disa lloje të mëlçisë. Për më tepër, në rast të rritjes së papritur të shtypjes së gjakut e cila mund të jetë e përcjellur me shenja apo kushte gjysmë kome, hixhami është ajo e cila duhet. Disa raste të sëmundjeve të mëlçisë, siç është dëmtimi i mëlçisë i cili nuk i përgjigjet medikamenteve apo ilaçeve, mund të shërohet me hixham. Disa sëmundje të gjakut siç është rritja e sasisë së hemoglobinës mund të kërkojë trajtim nga heqja e gjakut (hixhami) në mënyrë që të

ndalojë ndonjë efekt anësor. Është e rëndësishme të përmendet se numri i qelizave të kuqe rritet tek ata të cilët jetojnë në hapsira malore ku atje gjenden sasi më e vogël e oksigjenit. Kjo ndoshta edhe për shkak të temperaturës së madhe në të cilën gjendje gjëndrrat e djersës fillojnë aksionin dhe kjo shpie deri tek rritja e numrit të qelizave të kuqe. Hixhamja mund të kryhet për burrat, gratë dhe fëmijët. Cupping ose hixhama vepron duke shkaktuar reduktimin e dhimbjes që ndjejmë në trupin tonë. Në mjekësinë alternative dhimbjet shkaktohen nga dëmtimi i rrjetave të meridianeve të cilët teçojnë brenda trupit tonë energjinë jetësore, prandaj dëmtimi i këtyre kanaleve (meridianeve sjell dhimbje). Kjo vjen kryesisht me fillimin e stresit në trup,

çrregullimet e balancave hormonale dhe të lëngjeve, bllokimi i qarkullimit të gjakut në pika të ndryshme dhe temperaturë në muskuj e në artikulacione. Kur një kupë thithëse e hixhames vendoset në një zonë problematike, ajo thith dhe krijon një ngrohtësi qarkulluese të gjakut në vend dhe përreth vendit si dhe në thellësi të tij. Shumë shpejt do ndjeni që dhimbja është pakësuar në masë. Sipas mjeksisë alternative kur një organ është i sëmurë vuajnë dhe shumë organe të tjera, p.sh. nëse dikush vuan nga veshkat dhe është në moshë mesatare, ai person do thinjet me shpejt, do rrudhet shume dhe do i thahet lekura. Përdorimi i hixhamit apo cupping therapy ka shumë përfitime dhe mund të aplikohet në shumë trajtime.

Disa raste ku mund të përdoret me sukses hixhama janë:

1. Dhimbja e kokës
2. Dhimbjet e shpinës dhe shtyllës kurrizore në përgjithësi
3. Artrit
4. Kapsllëku dhe barkëqitjet
5. Dobësimi nga arsye të ndryshme
6. Shiatiku
7. Probleme të lëkurës
8. Shtrengime periodike të barkut
9. Mbipesha
10. Depresioni dhe migrena
11. Steriliteti tek femrat dhe meshkujt
12. Urinimi natën tek fëmijët etj.

Sëmundjet që mund të lehtësohen nga aplikimi i hixhames:

- Dhimbjet e kokës
- Dhimbjet e shpinës
- Dhimbjet e kyçeve dhe muskujve
- Infertiliteti
- Çrregullime seksuale të ndryshme
- Sëmundjet reumatike
- Hipertensioni arterial
- Infeksionet e gjirit
- Djerësitjet natën
- Ftohjet e sinuseve
- Mungesa e nuhatjes
- Temperaturat e larta
- Kapsllku, diarreha dhe barkqitja
- Dhimbjet e gjoksit
- Astma bronkiale
- Sëmundjet e gjakut

Hixhama është nga metodat më të mira të përdorshme dhe mbrojtëse për shëndetin e familjeve tona, prandaj le të behet metoda e jetës tonë për një shëndet cilësor dhe le të ringjallim edhe njëherë këtë sunet të Profetit i cili ka thënë: "Kushdo që

ringjall një sunet nga suneti im dhe njerëzit e praktikojnë atë, ai/ajo do të ketë të njëjtin shpërblim të atyre që e praktikojnë atë, pa i pakësuar atyre asgjë nga shpërblimet.." (Suneni Ibn Maxhah, 209)


Mrekullia tek deveja

Një kafshë në shërbim të njeriut

Argumentet dhe mrekullitë shkencore në Kur'an, janë logjika e vetme në kohët moderne, për të bindur ateistët dhe ata që dyshojnë në profecinë e profetit Muhamed, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të. Do të flasim këtu dhe do të shohim më nga afër një krijesë të habitshme, të cilën Zoti e ka përmendur veçanërisht në Kur'an, ku thotë: *"Vallë, a nuk i shohin devetë, se si janë krijuar?!"* (Gashije, 17)

Ne ndodhemi para një mrekullie që ka krijuar Zoti mbi tokë dhe ajo e meriton të quhet dhe të konsiderohet një mrekulli e një lloji të veçantë. Thotë Zoti në Kur'an: **"Vallë, a nuk i shohin devetë, se si janë krijuar?!"** Dhe qëllimi është **"A nuk e studiojnë njerëzit dhe a nuk thellohen në krijimin e deveve?!"**

Mendoj se është interesante se nga të gjitha kafshët e përmendura në Kur'an si: qentë, kuajt, zogjtë, karkalecat etj., Zoti ka zgjedhur devenë për të reflektuar mbi të. Ajo nuk është kafsha më e bukur në botë, nuk është më e shpejta apo më e forta,



nuk është më besnikja ose më e egra. Ajo është pak nga të gjitha këto, që i jep karakterin dhe vlera. Zoti i ka kombinuar të gjitha këto tipare dhe shumë më tepër, për të krijuar një kafshë të përshtatshme, të përkryer që na bën të reflektojmë jo vetëm për këtë, ajo mund të na mësojnë shumë për paraqitjen e vullnetit të Zotit. Deveja është absolutisht e përsosur për atë që duhet të bëjë dhe ku ka nevojë për të mbijetuar. Pa deve, udhëtimi në shkretëtirë do të ishte jashtëzakonisht i vështirë. Për shekuj me rradhë njeriu ka qenë në gjendje të kalojë shkretëtirat e mëdha të Arabisë dhe Afrikës me ndihmën e kësaj kafshe të guximshme. Edhe sot, deveja përdoret për të udhëtuar në zona të ndryshme. **"Edhe kafshët Ai i krijoi dhe në saj të këtyre ju mund të mbrohëni (nga të ftohtit), keni edhe dobi të tjera dhe prej tyre hani... Ato bartin barrën tuaj (të rëndë) në ndonjë vend (të largët) që ju do të arrinit atje me shumë vështirësi. Vërtet, Zoti juaj është shumë Bamirës dhe shumë Mëshirues."** (Nahl, 5-7)

Qafa e devesë, e mundëson që të ushqehet me bimë të larta dhe me barëra të shkurtër. Ajo është shumë funksionale



Por, si shfaqen mrekullitë e Zotit në këtë krijesë?

Paraqitja fizike:

Po të shohim, deveja ka një kokë të një madhësie të konsiderueshme, qafën, trupin me gungën në kurriz dhe katër këmbët. Secila prej këtyre pjesëve, është një mrekulli më vete. **Sytë** p.sh., përbëhen nga tre qepalla dhe jo dy. Devetë kanë një qepallë të tretë, e cila është një perde e tejdukshme, të cilën e përdorin gjatë udhëtimeve në shkretëtira dhe gjatë erërave të forta. Kjo perde shërben si syze mbrojtëse për sytë e deveësë, nga pluhurat dhe rëra e shkretëtirës.

dhe e ndihmon për t'u ushqyer sa më mirë.

Një e veçantë është se deveja ha gjithçka. Kjo bëri që një ekspert arab të thotë: "Kjo kafshë është shumë e çuditshme. Ajo arrin ta kthejë gjembin në proteinë dhe ushqim për trupin e saj."

Këmbët e deveësë janë të gjata dhe të fuqishme. Ato janë të pajisura me thundra të cilat janë izoluese dhe nuk e përçojnë elektricitetin. P.sh., nëse deveja me padronin e saj ndodhen në shkretëtirë në mes të një stuhie dhe një rrebeshi rrufesh, padroni i saj mund të vritet, kurse deveja jo. Kjo, për shkak të thundrave të saj izoluese. E tillë është dhe lëkura e deveësë, e cila në njëfarë mënyrë është një izolant elektriciteti.

Rruazat e gjakut të deveësë, janë plotësisht të ndryshme nga rruazat e gjakut të krijesave të tjera. Duhet ditur që deveja ka dy sisteme të qarkullimit të gjakut. Koka, qafa dhe trupi i deveësë kanë një sistem të caktuar qarkullimi, kurse këmbët kanë sistem tjetër.

Nëse deveja me padronin e saj do të humbisnin në shkretëtirë dhe do u mbaroheshin rezervat e ujit, cili prej të dyve do të vdiste i pari? Njeriut i vjen vdekja para deveësë për shumë shkaqe, ku më i rëndësishmi është për shkak të rruazave të kuqe. Kur njeriun e kap etja, ai fillon të marrë ujë direkt nga gjaku i tij. Kjo shkakton mpiksje të gjakut dhe goditje të diellit dhe për pasojë njeriu vdes për tre-katër ditë. Kurse deveja nuk ngordh kollaj për shkak të etjes. Ajo e magazinon ujin në indet e saj dhe jo ashtu siç mendojnë shumë njerëz në stomak. Në raste etjeje në shkretëtirë, deveja e thith dhe e përdor

këtë ujë të depozituar. Kur e përdor dhe shfrytëzon ujin e rezervuar, ajo fillon të përdorë lëndët dhjamore që gjenden në gungën e saj. Vetëm kur i përdor dhe këto rezerva uji, ajo detyrohet të thithë ujin e gjendur në gjak, por në këtë kohë kanë kaluar mbi dhjetë ditë e etur.

Tek të gjithë krijesat, duke përfshirë dhe njeriun, rruazat e kuqe të gjakut janë të njëjlojta, përveç deveësë, e cila ka rruaza me formë

boshti. Urtësia e kësaj qëndron në atë se deveja - në ditën e nëntë apo të dhjetë pa ujë dhe kur është pranë vdekjes - këto rruaza mund të depërtojnë në të gjithë indet, prej ku thithin temperaturën dhe e drejtojnë atë drejt lëkurës më pas. Kjo bën që deveja të mos pësojë goditje dielli në mes të shkretëtirës.

Buzët e deveësë janë të gjata dhe të trasha, gjë e cila ia mundëson të ushqehet pa probleme edhe me gjemba. E habishme është se si i kthen gjembat, në proteina, të cilat në vetvete janë mishi i saj që hahet dhe qumështi që pihet. Përgjigja e kësaj pyetje, i ka vënë në siklet dhe vështirësi dhe shkencëtarët.

Ajo që e ndihmon për tretjen dhe përpunimin e çfarëdolloj ushqimi, është dhe **aparati tretës** i deveësë. Ajo ka tre stomaqe dhe të tre funksionojnë dhe tresin ushqimin si jo më mirë.

Armët mbrojtëse të deveësë:

Por si përballen deveja me rreziqet e ndryshme në shkretëtirë? Po të shohim tek kafshët më fizik të vogël, gjejmë se ata me të ndjerë rrezikun fshihen dhe vrapojnë në përpjekje për ta shmangur atë. Kurse deveja, duke qenë se ka fizik të madh, Zoti i Madhëruar e ka pajisur me dy armë të efektshme. Kur deveja është e sapolindur, ajo e fiton mundësinë për të qëndruar në këmbë dhe për të ecur, pas dy orësh. E dyta është se deveja arrin ta hedhë këmbën e parë të djathtë, njëkohësisht me të djathtën e pasme. Po kështu, të majtën e përparme me të majtën e pasme. Një mënyrë të tillë të ecurit, e gjejmë vetëm tek deveja dhe tek xhirafa.

Mbresëlënëse tek deveja është dhe **procesi i urinimit**. Të gjithë kafshët ripërtypëse,

nëse nuk urinojnë, këto ujëra shkaktojnë helmimin e kafshës dhe rrjedhimisht ngordhin. Kjo ndodh tek të gjitha kafshët ripërtypëse, përveç deveve. Ajo e merr urinën e saj dhe e dërgon përsëri në mëlçi, e cila nga ana e vet, e filtron dhe merr lëndët azotike që gjenden në urinën e saj dhe i shndërron në ushqim. Lëndët azotike që gjenden në urinën e deveve, janë rezultat i tretjes së proteinave dhe lëndëve ushqyese. Këtë lëndë, deveja e merr dhe e riciklon duke e shndërruar përsëri në proteinë dhe lëndë ushqyese. Përveç proteinës që përfitoi, ajo përfiton dhe diçka tjetër jetësore nga ky proces, ujin. Kështu, ajo vret dy zogj me një gur. Një proces të tillë kaq të ndërlikuar, nuk e gjejmë tek asnjë kafshë tjetër.

Ana shpirtërore dhe emocionale e deveve

Në letërsinë arabe gjejmë shumë elementë që flasin mbi anën shpirtërore dhe emocionale të deveve. Kur flasim mbi anën shpirtërore të deveve, është diçka e bukur. Ajo ka ndjenja, është besnike, dëshpërohet dhe qan. Devetë kanë karakteristike qetësinë, bindjen dhe nënshtrimin ndaj njeriut. Devenë mund ta tërheqë dhe ta çojë nga të dojë edhe një djalë i vogël.

Tregon imam Razij: "Një herë humbëm rrugën në shkretëtirë. Për ta rigjetur përsëri, ne e lamë devenë të lirë dhe vazhduam ta ndjekim, derisa na orientoi përsëri drejt rrugës së duhur."

Një pyetje që lind është: "A është e mundur që këtë senduk ta vendosim dhe mbi kurrizin e mushkës apo të kalit?" Diçka e tillë është e pamundur. Deveja është e lidhur ngushtë me jetën e shkretëtirës dhe atë nomade, ashtu siç është i lidhur shpirti me trupin.

Po ta studiojmë devenë nga ana gjuhësore, do të shohim që arabët e quajnë atë "xhemel", anglezët "camel", koptët e Egjiptit "Kamul" dhe shihet qartë që janë fjalë të përafërta me njëra-tjetrën.

Këndështrimi i islamit në lidhje me devenë

Deveja është përdoruar nga Profeti dhe nga sahabët si mjet për të ecur duke qenë se në kohën e profetit nuk kishte automjete si këto që janë në ditët tona, e

përdornin për të luftuar mbi të, për t'u ushqyer, për mjekim dhe jo më kot Zoti e ka përmendur në Kur'an, e ka dalluar nga kafshët e tjera dhe i ka kërkuar njeriut që të meditojë për krijimin e saj: "**Vallë, a nuk i shohin devetë, se si janë krijuar?!**" [El Gashije, 17].

Devenë e ndeshim që në kohën e profetit Salih që iu dërgua popullit të Themudit. "dhe Themudit u dërguam vëllanë e tyre Salih" (11:61)

Populli i kërkoi Salihut argumente bindëse që vërtetonin se ai ishte me të vërtetë i dërguar nga Zoti. Atëherë Zoti u dha atyre si provë një deve femër, e cila doli nga një shkëmb i madh, mirëpo njëkohësisht i sprovoi ata duke u vendosur disa kushte të caktuara. Por, ata e vranë devenë. "**Kështu ata e therën devenë dhe e mohuan në mënyrë të pacipë urdhrin e Zotit të tyre dhe thanë: "O Salih! Sille ndëshkimin që na premtove, nëse je me të vërtetë i dërguar i Zotit."** (El-Araf, 77)

Gjithashtu devenë e përdornin në masë edhe arabët. Vetë profeti ka pasur deve në përdorimin e tij. Kur Profeti emigroi nga Meka në Medine banorët e saj po e prisnin të gëzuar dhe secili prej ensarëve donte që deveja e profetit të ndalonte tek shtëpia e tij. Deveja e profetit ndaloi tek shtëpia e Ebu Ejjub el Ensariut dhe profeti atë natë fjeti tek shtëpia e tij. Edhe për ndërtimin e xhamisë në Medine në kohën e profetit u vendos ndërtimi i saj në vendin ku deveja do të ndalonte dhe do të ulej.

Përsa i përket thënieve profetike, ja si përmendet deveja në lidhje me kurbanin. Kurbari më i mirë është deveja, pastaj lopa, pastaj delja, pastaj një pjesë nga deveja apo nga lopa.

Thotë Pejgamberi lidhur me xhumanë (ditën e premte): "*Kushdo që vjen më herët, është sikur të ketë bërë kurban një deve...*"

Enes ibn Malik transmeton se një delegacion nga fisi Ukkel erdhi tek i Dërguari i Zotit dhe i dha besën për pranimin e Islamit. Por ata nuk ju përshtatën ushqimeve të tokës (së Medines), kështu që u sëmuren dhe iu ankuan për këtë gjë të Dërguarit të Zotit. Ai u tha: "**A nuk dilni dhe shkoni te bariu ynë, që të pini nga qumështi i deveve?**"

Buhariu transmeton nga Abdullah Ibn Umer: "*Njerëzit bashkë me të dërguarin pushuan tek një tokë e Themudit e quajtur el-Hixhr dhe ata morën ujë për të pirë dhe për të zënë brumin. (Kur i dërguari dëgjoi rreth kësaj), i urdhëroi ata të derdhnin ujin që kishin mbushur në pusët e tyre (pusët e Themudit) dhe brumin t'ua jepnin deveve për të ngrënë. I urdhëroi ata të mbushnin ujë (për vetet e tyre) nga pusi ku deveja (e Salihut) pinte ujë".*

"Nuk ka dyshim se ata që përgenjështuan argumentet Tona dhe nga mendjemadhësia u larguan prej tyre, atyre nuk u hapen dyert e qiellit dhe nuk do të hyjnë në xhennet deri të futet deveja nëpër vrimën e gjilpërës." (El - A'rafë, 40)

Çështja është se këtu ka një rend parapëlqimi mes deveve, lopëve dhe deveve në afrimin ndaj Zotit nëpërmjet kurbanit. Padyshim, kurbanit është një nga aktet më madhështore të adhurimit, nëpërmjet të cilit mund t'i afrohem me shumë Zotit. Një deve është më e vlefshme dhe më e dobishme.

Ata thanë: "Po", dhe shkuan, pinë nga qumështi i deveve, u shëruan...

Diuretikët dhe laksativët janë ilaçe të njohura kundër edemës. Ata bëjnë të mundur nxjerrjen jashtë të urinës. Diuretikët (ilacet që bëjnë të mundur nxjerrjen e lëngut të tepërt me urinë) janë gjetur në urinën dhe qumështin e deveve gjatë ciklit të mbarësimit të saj. Për këtë arsye i dërguari i Zotit ua këshilloi këtë ilaç duke qenë se cilësia e qumështit e bën të mundur dhe siguron urinim të përshpejtuar, është laksativ i lehtë dhe rregullon punën e zorrëve.

Përmbajtja e qumështit të deveve

Qumështi i deveve është shumë i pasur me vitamina, sidomos vitaminën C. Është me vend që të pyesim? Përse në veçanti vitaminën C? Padyshim këtu ka diçka të rëndësishme. Deveja jeton në shkretëtirë, kurse vitamina C, kryesisht gjendet tek frutat e freskëta, që nuk gjenden në shkretëtirë. Duke qenë se banorët e shkretëtirës janë të privuar nga këto fruta dhe rrjedhimisht nga vitamina C, ata e kompensojnë nevojën për vitaminën C me anë të qumështit të deveve, i cili është i pasur me këtë vitaminë.

Në shekuj, deveja ka qenë kafshë me të cilën krenoheshin dhe mburreshin arabët. Mbi kurrizin e deveve, arabët vendosnin një sënduk (heudexh) të mbuluar me pëlhurë, ku qëndronin kryesisht gratë.

Qumështi i deveve konsiderohet ushqimi bazë i beduinëve të shkretëtirës, të cilin e konsiderojnë qumështin më të mirë që ekziston. Qumështi i deveve ndryshon për nga dobitë dhe përbërja e tij në varësi të prejardhjes së deveve, fazës së urinimit dhe mjeljes, të moshës, llojit të ushqimit që ha si dhe në varësi të sasisë së ujit që magazinon për të pirë. Qumështi i deveve është qumështi që afron më shumë me qumështin e gjirit të njeriut, madje në shumë raste beduinët e privilegjojnë atë mbi qumështin e nënës për foshnjat e tyre. Shija e tij gjithashtu është e ndryshme dhe sillet nga shumë i ëmbël deri në të kripur. Qumështi i deveve përmban proteinë nga 4-25%, përmban lëndë të ngurta nga 10-15%, yndyrë sidomos në fillimin e kohës së mjeljes dhe urinimit, deri në 2-3%,

lëndë sheqerore dhe posaçërisht lacteous (sheqeri i qumështit) nga 3-6%, klorid sodiumi nga 14-27%, minerale si: hekuri, kalciumi dhe fosfori, si dhe vitamina, si: B1, B2 dhe C.

Një studim tjetër i bërë nga organizata "Zaid" për kërkimet bimore dhe mjekësinë popullore, në Abu Dhabi, arriti në përfundimin se ekziston mundësia për prodhimin e një antibiotiku nga qumështi i deveve, i cili ka mundësi të shërojë sëmundje të tilla si plasja, sida, infeksioni i mëlçisë (hepatitis) dhe tuberkulozi.

Sëmundjet, në trajtimin e të cilave ndihmon qumështi i deveve

Qumështi i deveve ndihmon në parandalimin e kancerit, sepse është e pasur me antioksidantë dhe ndihmon në trajtimin e shumë sëmundjeve, si: edema, verdhëza, problemet e shpretkës, tuberkulozi, astma, anemia, hemorroidet, problemet në funksionet e mëlçisë, diabeti (është zbuluar se qumështi i deveve ka vetinë e prodhimit të hormonit insulinë dhe pakëson përqindjen e kolesterolit në trup, gjë e cila ndalon arteriosklerozën dhe goditjen e njeriut nga sëmundjet e ndryshme të zemrës), rrufa, bronkiti, ulçerën e stomakut, kancerin dhe sëmundjet e mëlçisë dhe inflamacionet e saj (hepatitin). Qumështi i deveve ndihmon gjithashtu në uljen e peshës për shkak të përmbajtjes së tij të pakët të energjisë dhe yndyrës, dhe njëkohësisht ai forcon trupin dhe shikimin.

Libri i Zotit, Kur'ani famëlartë, duhet lexuar me meditim pasi ka në të mrekulli.




Siç e pamë në këtë temë, vetë shkenca fton njerëzit për meditim dhe në besim të Zotit, Krijuesit të gjithësisë.



ACIDI FOLIK VITAMINA

THESAR

Vitamina që mund të ndryshojë jetën



QË MUND TË NDRYSHOJË JETËN

nga: Valentina Hoxha

Nëse gratë kanë acid folik të mjaftueshem në trupin e tyre përpara shtatëzarisë, kjo vitaminë komplekse B mund të reduktojë rrezikun e defekteve nervore të lindura në mbi 70%. Defektet e gypit nervor (NTD) janë një grup defektesh të lindura që ndikojnë në sistemin nervor qëndror.

Të kesh një bebe të bukur dhe të shëndetshëm është ëndrra e të gjithë çifteve që presin të bëhen prindër. Megjithatë ëndrrat jo gjithmonë bëhen realitet. Arbrit ishte një djalë shumë i shëndetshëm. Ai flinte dhe ushqehet shumë mirë. Në fakt ai ishte shumë mirë dhe çdo gjë shkonte për mrekulli deri në moshën pesë muajshe. Mami i Arbrit filloi të shqetësohej kur ajo vuri re që sytë e tij kishin filluar të shtrembëroheshin dhe ai ndaloi rrotullimin, gugatjet dhe të qeshurat. Më vonë ai nuk ishte në gjendje ta mbante kokën e tij drejt lart. Mami i Arbrit e kishte vizituar atë në disa doktorë dhe më në fund ai u diagnostikua me mungesë të elementit folat, i cili bëhet shkak për shumë sëmundje.

Të gjithë prindërit bëjnë çdo gjë që munden për t'i mbajtur fëmijët e tyre të

shëndetshëm. Krijimi i foshnjës në mitrën e nënës mbetet ende një mbrekulli jo plotësisht e shpjeguar nga shkencëtarët. Lindja ka qenë një mister në jetën e qënieve njerëzore që në fillimet e historisë. Burimet fetare tregojnë fazat e rritjes së foshnjës në mitrën e nënës, projektimi perfekt i mjedisit që plotëson nevojat e foshnjës me gjithçka që i duhet, të gjitha si shembujt e mëshirës dhe fuqisë së Zotit. Ndonëse i gjithë procesi i shtatëzarisë zhvillohet pothuajse pa ndërhyrjen nga jashtë, janë disa përkujdesje që prindërit duhet të marrin për të patur një fëmijë të shëndetshëm.

Si të fillojmë të kujdesemi për beben që përpara shtatëzarisë?

Shkenca e bën të qartë se ne nuk duhet të presim deri sa ta mbajmë në krahët tonë foshnjën para se të kujdesemi për të. Por si mundemi në të kujdesemi për foshnjën madje që përpara mbetjes shtatëzanë. Një nga përgjigjet është shumë e thjeshtë: nëpërmjet marrjes së acidit folik! Nëse gratë kanë acid folik të mjaftueshem në trupin e tyre përpara shtatëzarisë, kjo vitaminë komplekse B mund të reduktojë

rrezikun e defekteve ner-vore të lindura në mbi 70 %. Defektet e gypit nervor (NTD) janë një grup defektësh të lindura që ndikojnë në sistemin nervor qëndror. Gypi nervor formohet në embrion ndërmjet javës së katërt deri në javën e gjashtë dhe pastaj mbyllet. Ky gyp nervor bëhet palca kurrizore, shpina, truri dhe kafka e bebit. Nëse gypi nervor nuk mbyllet plotësisht, foshnja mund të ketë defekte nervore të lindura, në këtë rast foshnja mund të ketë mangësi zhvillimi në tru, palcën kurrizore ose në të dyja.

Defektet e gypit nervor (NTD) ndodhin në shtatëzaninë e hershme, madje përpara se pjesa më e madhe e grave të mësojnë se kanë mbetur shtatëzënë.

Defektet nervore të lindura më të zakonshme janë: anencephaly, truri nuk është zhvilluar plotësisht ose mungon komplet, kurse në spina bifida pjesa e palcës kurrizore të foshnjës mbetet jashtë trupit.

Folate deficiency dhe acidi folik

Folate ndryshe i quajtur vitamina B9, është vitaminë e tretshme në ujë. Ajo është themelore në jetën njerëzore dhe është gjetur në disa ushqime natyrore të tilla si në: mëlci, në frutin dhe lëngun e qitros, nga gruri, dhe në gjethet jeshile të perimeve.

Acidi folik mund të përftohet nga shtesat dhe nga përforcimi i bukës dhe drithrave. Acidi folik dhe Folate (VB9) punojnë për të njëjtën qëllim, dhe në këtë artikull termat janë përdorur në vend të njëri-tjetrit.

Nga mungesa e Vitaminës B9, trupi nuk është në gjendje të transportojë acidin folik në tru, (duke përfunduar në lëvizshmërinë e problemeve, verbërinë dhe në krizë (apopleksi).

Gratë shtatëzana në veçanti mund të jenë në një rrezik shumë të madh duke lindur fëmijë nën peshë dhe të parakohshëm, që mund të kenë defekte nervore të lindura.

Tek fëmijët mungesa e Vitaminës B9 mund të ulë zhvillimin e përgjithshëm. Tek të rriturit, shfaqet një lloj anemie afatgjatë. Ka gjithashtu dhe të tjera shenja të mungesës së Vitaminës B9 të tilla si: dhimbje koke, humbja e oreksit, maisje (enjtje) e gjuhës, diarre, amnezi dhe ngacmueshmëri.

Pse është i rëndësishëm acidi folik?

Acidi folik luan një rol shumë të rëndësishëm në një sërë procesesh të trupit duke përfshirë

mirëmbajtjen dhe rregullimin qelizorë, formimin e rruazave të kuqe të gjakut (që siguron oksigjen për indet), formimin e rruazave të bardha të gjakut (të cilat mbrojnë trupin kundrejt sëmundjeve infektive), sintezën e ADN-së (materiali trashëgimik) dhe në metabolizmin amino acid. Gjithashtu ai luan një rol vendimtar në parandalimin e sëmundjeve njerëzore. Shtesa e acidit folik nuk mund të ndalojë insult-et cerebrale dhe sëmundjet e zemrës, por studimet kanë treguar që ai mund të reduktojë rrezikun e goditjeve kardiace dhe insult-et cerebrale. Në kërkimet e fundit shkencore ka rezultuar që acidi folik mbështet funksionimin e damarëve të gjakut, të cilët sigurojnë lëvizjen e gjakut drejt zemrës. Shtimi i acidit folik ndihmon në mbrojtjen kundrejt zhvillimit të disa (formave) sëmundjeve kanceroze si: kanceri në zorrën e trashë, kanceri në cervikal (tek gratë), kanceri në ezofag, kanceri në gji, dhe kanceri në stomak.

Shumë eksperimente shkencore kanë treguar që njerëzit që vuajnë nga sëmundja e Alzheimer-it kanë nivel të ulët të acidit folik në gjakun e tyre. Kështu që, nuk është befasuese që acidi folik është vendimtar për funksionimin e trurit dhe luan një rol të rëndësishëm në shëndetin mendor dhe emocional.

Nëse ti je një grua e matur dhe ke në plan të kesh fëmijë ndonjë ditë, ti duhet patjetër të fillosh të marrësh acidin folik sepse ndonjë ditë do të marrësh vesh se je shtatëzënë, truri dhe shpina e foshnjës tënd do të jenë formuar tashmë. Ja pse është e rëndësishme për gratë të marrin një sasi të mjaftueshme të acidit folik përveçse nuk janë duke planifikuar ndonjë shtatëzani.

Vetëm gratë duhet ta marrin acidin folik?

Në të vërtetë jo. Çdo burrë dhe grua e rritur duhet ta konsumojë për të ulur rrezikun e sëmundjeve të zemrës, kancerit në zorrën e trashë dhe të sulmeve cerebrale. Nëse kjo është vitamina që mund të ndryshojë jetën tonë përgjithmonë, sa duhet ta konsumojmë ne atë dhe ku mund ta gjejmë? Ju mund ta gjeni acidin folik në ushqimet natyrore të tilla si: mëlcia, arrat, gjalpi i kikirikut, bizelet e thata, fasulet, portokallet, në lëngun e domates dhe ananasit, pjeprit, shpërënga, avokadoja, dhe në gjethet jeshile të perimeve në produktet e grurit pak të përpunuara

DALLGË JETË

nga Entela Hidri

Ishte e pabesueshme se si një njeri në dallgët e jetës mund të transformohet dhe të tjetërsohet në atë mënyrë. Pasqyrat e jetës përfitonin po të njëjtin imazh, po atë fytyrë të egër dhe mizore, por shpirti i tij nuk ishte po ai. Diçka e madhe e pakuptueshme kishte ndodhur. Jeta e tij kishte qenë e stërmundimshme dhe e vështirë, prandaj edhe fytyra e tij kishte pamje të egër.

Më parë edhe njerëzit më trima do të strukeshin përpara fytyrës së tij, por tani ai përpara kësaj fytyre miturore, të njomë, ndihej i pafuqishëm.

Kishte punuar për vite me rradhë në sigurimin e shtetit. Ishte penduar thellë në shpirt për këtë zgjedhje, por ideja se po të hiqte dorë mund të ndëshkohej nuk e kishte lënë të kthehej pas.

Gruaja e kishte lënë të ve që kur vajzat e tij, Eni dhe Blerina, ishin të vogla.

Ai kishte qenë një baba autoritar dhe i sertë dhe kjo kishte krijuar një hendek shumë të madh mes tij dhe dy vajzave të mbetura tashmë pa nënë.

Eni tani ishte njëzet e dy vjeçe dhe ishte në përfundim të studimeve për gazatari. Kjo degë qe një zgjedhje e Enit e cila i kishte krijuar shumë vështirësi me të atin.

Blerina ishte tetëmbëdhjetë vjeçe dhe ishte në vitin e katërt të shkollës së mesme.

Petriti edhe pse i sertë në thellësinë e shpirtit, ndihej i pafuqishëm përpara engjëjve të tij.

Në jetën e tij po ndodhte diçka që edhe ai vetë nuk do ta kishte besuar kurrë.

Eni kishte disa kohë që kishte shfaqur preferenca të hapura për disa praktika fetare të një feje që nuk i përkiste familjes së saj. Prejardhja e tyre fetare ishte e krishterë, por Eni kishte filluar të shfaqte interes për fenë myslimane. Dëshirat e saj po i kalonin kufijtë e një praktike të thjeshtë, sepse ajo kishte filluar të frekuentonte rreth shoqëror me bindje fetare islame. Kishte filluar madje hera-herës të frekuentonte edhe xhaminë.

Një ditë Eni kishte patur një konflikt të egër me të atin, i cili kishte vendosur t'i paraprinte dëshirave të saj dhe ta kundërshtonte me forcë. I ulur tashmë në dritare ai po kujtonte atë debat:

-Ti ke frikë baba, sepse unë kam gjetur diçka që më plotëson atë boshllëk shpirtëror që ma ke krijuar ti.

-Sot ti Eni, ime bijë nuk do të shkosh te ato miket e tua të famshme.

-Do të shkoj, sepse ti nuk më ndalon dot, edhe sikur të më dëbosh. Baba, ka disa gjëra që i kalojnë kufijnjtë e fizikes dhe e kanë emrin ndjesi shpirtërore, gjë të cilën fatkeqësisht ti nuk e njeh. Ti kujton se ke të bësh me të pandehurit e tu, por gabon! Ti mund të më mbyllesh mua, por jo shpirtin tim, sepse ai i përket vetëm Zotit tim.

- Ti je çmendur. Zoti ynë është Jezui, e gjithë bota kthehen në të krishterë kurse ti...

- Bota rrotullohet rreth boshtit të saj,

kurse unë rrotullohem rreth boshtit tim.

Këto fjalë po i ushëtinin në kokë dhe mendonte se me të vërtetë ai kishte krijuar një boshllëk të pazëvendësueshëm në zemrat e bijave të tij. Si mund të kishte qenë aq i pandjeshëm ndaj tyre!

-Babi,- dhe një dorë i rëndoi në qafë,- eja është koha për t'u falur. Ai kishte disa kohë që kishte filluar të shoqërohej me Enin. Kjo kishte filluar si një dëshirë për të kontrolluar jetën e saj të re dhe dashur pa dashur ai kishte filluar të mësonte diçka për këtë fe që më parë e kishte paragjykuar me kilometra larg.

Kishte gjetur në të diçka që e plotësonte, e bënte të ndihej mirë, madje kishte lidhur me bijat e tij një urë komunikimi që nuk e kishte pasur me to, as e ëma e tyre.

Kujtonte çastin kur në mes të natës pranë të gdhirës kishte vënë re një njeri që ecte në koridor. E kishte ndjekur me sy dhe kishte njohur siluetën e Enit. Më pas kishte vënë re se si ajo bënte disa lëvizje në mes të errësirës, të cilat ai nuk i kishte kuptuar dot. Të nesërmen në të njëjtën orë ai kishte parë të njëjtën skenë. Dhe më në fund e kishte kuptuar se Eni kishte filluar të kryente një praktikë sa të shenjtë aq edhe mistike që në fenë myslimane quhej falja e namazit.

Nuk kishte ditur se si të reagoonte dhe më në fund kishte bërë sikur nuk dinte asgjë.

Ai kishte menduar se Eni së shpejti do të lodhej dhe do të hiqte dorë nga këto sjellje, por për këtë ai nuk mund të ishte i sigurtë aspak, madje ai kishte vënë re se ajo ishte më e dhimbshme ndaj tij dhe sillej me të më me dashuri. Të ishte kjo sjellje rrjedhojë e kësaj feje?! Kishte vënë re edhe diçka që për karakterin e saj ishte pak e çuditshme. Ajo kishte nisur të përhëndeste të gjithë fqinjët, madje edhe t'u shërbente për ndonjë gjë atyre.

Një ditë me shi ai kishte vendosur të mos dilte dhe të fliste hapur me të bijën.

- Eni unë dua të flas me ty për disa gjëra. Unë kam vënë re sesi ti ke filluar të falesh dhe nuk e di se si e ke marrë këtë vendim, prandaj dua nga ty një shpjegim të vlefshëm për një baba në pozitën time.

-Babi, unë tashmë jam më e pjekur dhe jam e aftë të bëj zgjedhjet e mia edhe pse ti nuk mendon të njëjtën gjë me mua. Unë që kur jemi ndarë nga nëna jonë kam në zemër një boshllëk të cilin nuk e kam mbushur dot kurrë. Nuk mendoj se ky boshllëk do të mbushet ndonjëherë plotësisht, por mendoj se në këtë fe kam gjetur diçka, e cila më bën të ndihem mirë me veten dhe me të tjerët. Në fenë islame femra ka një status të caktuar dhe nuk lejohet të diskriminohet dhe të keqtrajtohet siç bëje ti me nënën time ndjesë pastë. Në fenë time respektohen të moshuarit, jetimët, të pafuqishmit. Baba urrejta nuk ekziston, por ajo është një mungesë e theksuar e dashurisë. Mosrespekti nuk ekziston, por ai është një mungesë e theksuar e respektit. Zhurma është mungesë e qetësisë e shumë e shumë si këto, por kur njeriu kalon një kohë të gjatë duke pasur mungesa dhe në këtë rast nuk e kam fjalën për mungesa fizike, por shpirtërore, atëherë njeriu zbrazet si ajo ena pa ujë dhe njeriu mbetet pa një shpirtërore, e cila i jep forcë të ecë përpara. Unë kam gjetur një forcë shpirtërore që më bën të ec përpara, që më bën të shikoj në sy të vërtetën dhe të kuptoj se nuk të kam urryer kurrë dhe të kuptoj që ti ke këtë natyrë imponuese që ke, sepse kështu të ka mësuar jeta të jesh.

-Çfarë do të thuash me këtë që the, unë vij për të të tërhequr veshin ty dhe je ti ajo që po më kap nga të dy veshët mua?

-Kështu është baba, sepse ti ke qenë përherë shumë i zënë dhe nuk ke pasur kurrë kohë të shohësh gabimet e tua, kurrë! Unë ndihem rahat me këtë zgjidhje të re dhe mendoj se kjo do të ishte shumë e mirë edhe për ty, sepse edhe ti si gjithë të tjerët je një krijesë që ke dobësitë e tua dhe që ke nevojë

për ata që ti e quan forcë e mbinatyreshme, kurse unë me një dëshmi të fortë e quaj Zot.

Ai kujtonte shpesh këtë bisedë nga e cila që larguar pa e përfunduar. Por, me kalimin e kohës zemra e tij që zbutur dhe ai ishte ndjerë si i pafuqishëm dhe si i tërhequr magnetikisht nga një forcë, e cila i thoshte se nuk kishte se ç' Humbiste dhe se kjo mund të ishte një mënyrë për të bërë diçka për të bijat e tij dhe ndoshta për të rifituar dashurinë e tyre.

Një ditë ai kishte vendosur të shoqëronte të bijën për në xhami. Njerëzit derdeshin rrugës dhe sikur thitheshin nga një vrimë e zezë e zhdukeshin brenda dyerve të xhamisë. Eni nuk ecte, ajo fluturonte me krahë të padukshëm lumturie dhe këtë mendohej ta shprehte me çdo gjest të mimikës së saj.

Diku ajo vuri re disa shoqe të saj që e prisnin. I përshëndeti jo me dorë, por me krahë:

-Ej, babai im, ky është babai im! - shqiptoi ajo me zë të lartë dhe krenare. Edhe shoqet e saj më përshëndetën përzemërsisht.

Më pas ne u ndamë dhe secili nga ne mori drejtimin e tij.

Që nga ajo ditë unë e bëra shpesh këtë gjë derisa edhe fillova të falem rregullisht dhe me përkushtim.

Ne u bëmë një familje e qetë dhe kompakte, sepse ne gjetëm atë gjë që na kishte munguar që me kohë: Dashurinë, respektin për njëri-tjetrin dhe mbi të gjitha për Zotin tonë.

Atij i takojnë falenderimet dhe lavderimet, Zotit të Botëve.

Mos e anashkaloni historinë time. Lexojeni dhe meditoni për të.

nga vëllai juaj J. P



SUPPLEMENT

PALESTINA

PLUS



Kishin kaluar muaj të shumtë, por edhe vite po aq shumë kur debati mbi problematikën politike që mbërthen realiteti i dy vendeve gjithnjë armike Palestinë-Izrael sikur që molepsur. Palestinën kushdo e pa në këto vite që shkuan të përbotur e të përgjakur, të rrënuar e të sakatuar, e po kushdo e quajti atë, vend të kamikazëve, vendin që njeh dhunë, gjak e terror.

Ndërkohë, ju që dini të lexoni, të njihni historitë, të ndani të vërtetën nga e stisura, gënjeshtren nga e qarta prej kristali, ku jeni?

A e dëgjuat së fundmi lajmin e kobshëm, që erdhi pikërisht nga ai vend që ju e quani të vuajtur, nga dhuna që po i shkakton Palestina? E patë se ç'ishte në gjendje të bënte një makineri aq ç'njerëzore sa ia kalon asaj hitleriane? Ajo ishte makineria e territ, ajo izraelite. Gjithnjë në bankën e gjykatësit të shtrembër duke e quajtur Palestinën vend kamikazësh, tashmë Izraeli më qartë se kurrë i tha botës mbarë se është sinonim i të "humburës" që për të mbijetuar kërkon gjak e vrasje. Atje flet terrori, udhëzon padrejtësia e ku kamikazi është thjesht e qartë bir izraelit.

Kush mendoni ju, tashmë se është kamikaz? A ikën si pa qenë askush të paktën 9 aktivistë paqeje pro kauzës së Palestinës, të ardhur nga vende të ndryshme, madje jo nga vendet e

lindjes e ato islame, por nga një botë tjetër perëndimore si për t'i thënë Izraelit "ndale marrëzinë". E gjithë lindja e perëndimi sot janë kundër teje, e nëse ti nuk pendohesh, për gjakun e derdhur e kufomat që ikin drejt vendeve të tyre si dëshmorë paqeje, ti i vlerëson si miza që ndotnin ambjentin, ti je vënë në shënjestër të dënimit mbarëbotëror, por edhe të dënimit të madh e të pashmangshëm të asaj dite që ti ndoshta e mohon sërish.

Aleat me të ashtuquajturën super-fuqi botërore të bëjnë të ndihesh i fortë e i pathyeshëm. Por, edhe pse të vakëta reagimet e supeufqisë, ti je sot ai i dënuari me burgim pa afat. Drejt teje është drejtuar gishti injorues i asaj çfarë flisje se je popull i paqtë dhe ishe viktimë bombash palestineze, por jo, maska prej rrenacaku ndër shekuj, sot u gris për botën, por besimtarët e: "Librit" e dinë të vërtetën e Kudsit e ky emër ndoshta ju kall datën.

Sulmi i anijes që s'ishte gjë tjetër veçse ndihma për palestinezët e aktivistë paqësore nga 40 a më shumë vende të botës në ndihmë të nevojtarëve, ishte akti barbar që të numëroi si vendin ku lulëzon krimi mbështetur kjo nga superfuqitë ku lulëzon demokracia e madhe prej shekujsh mëkatarë.

Ajo ngjarje - goditi ligjin ndërkom-bëtar - u shprehën plot njerëz të mëdhenj të politikës në Top Fox, Euro News e kudo. Kjo goditi paqen dhe dinjitetin njerëzor.

Anija që lundronte në ujërat ndërkombëtare sikur asgjë të mos ishte, kishte frymë njerëzish, që ndoshta po e tmerronin gënjeshtren e madhe që mbështjell kauza izraelite.

"Izraeli nuk pendohet, SHBA zbut tonet qortuese, ..." - përse ndodh kështu?!



Përse zbuten tonet qortuese kur bëhet fjalë për Izraelin e kur është çështja për vendet qartësisht islame, shigjetohen si në arenë të flaktë lufte myslimanët?

O Populli i superfuqisë! Ju vërtet jeni quajtur superfuqi, por dora e hekurt ju ka shndërruar në mekanizma përçudnues, ju që mbani drejtësinë në dorë, demokracinë në tryeza e dossier poshtërues, hidhini sytë tek ajo çfarë po i bëni botës, e cila ju emëron "demokratë".

Ajemi të barabartë të gjithë para ligjit? Ky është ligj i demokracisë botërore, i SHTËPISË së bardhë dhe asaj "të zezë" që po ndërtoni kundër së vërtetës historike mes këtyre dy kombeve.

Armët e vdekjes me të cilat ngrini marrëdhëniet tuaja fare mirë do duhej të ishin pako dhuratash për fëmijë e gra palestineze, të ngelura jetimë e të veja nga sulmet izraelite, e jo plumba mizorë mbi të pafajshmit.

Kjo është thirrja e çdokujt: "Mos më lëndoni! Loti im peshon shumë, e jeta ime kushton shtrenjt tek Zoti im!"

Kjo është një thirrje që buçet sot në çdo skaj.

Historia e ka treguar se superfuqitë ndërhyjnë atëherë kur janë vranë me mijëra njerëz, siç ishte rasti i Bosnjës, i Çeçenisë, i Kosovës e tani i Palestinës.

Ndërhyrje të tilla vijnë si krahasim i atij mjekut që nuk vjen me bisturi shërimi, por kthehet në varmihës për pacientët e tij dhe kjo është e kobshme, këtë nuk e duron drejtësia Hyjnore, por çdo gjë ka një fund dhe fundi i atij që vret një besimtar është i tmershëm! Po për ata që vranë më shumë, e më shumë...?!

Ligji i tillë, ku më i madhi "mbyt" më të voglin gjen shprehje veçse në xhungël, gjë që tregon se superfuqitë e sotme botërore nuk janë gjë tjetër veçse xhungël shtrigash e geto mëkatarësh tek rrinë aty mbytyrazi për të thurur planet e humbjes së tyre epokale.



Anijet, me velat e bardha që garonin me qiejt gjithmonë kanë qenë simbol lirie. Por, qetësia e saj nëpër ujërat ndërkombëtarë acaroi të vetëquajturin "mitin e madhështisë". Kështu sulmi që bëne forcat izraelite mbi karvanin e lirisë, i cili nuk ishte një flotë ushtarake, apo luftarake që po luftonte Izraelin dhe as shtetin izraelit, nuk kishte qëllim tjetër vetëm që të çonte ndihma ushqimore për ata fëmijë, gra, plaka e pleq që po vdesin për bukën e gojës! Vriten të rinj e të reja në duart e prindërve, në shtëpitë e tyre, në shtëpinë e Zotit... Ky është një realitet që e di e gjithë bota dhe normalisht dihej se cili do të ish reagimi dhe çfarë ndodhi.

Gaza vazhdon të jetë e izoluar.

Si ka mundësi që mbarë bota të mos e shohë se çfarë po ndodh në Gaza?!! Duhej të pritnin karvanin e lirisë që të shikonin se çfarë ka ndodhur në atë vend ku kundërmojnë kufomat e pafajshme dhe ku kuqëlon gjaku i bijve të nënave të përvuajtura?

A nuk e di bota se çfarë po ndodh në Palestinë?!!

Patjetër që e di ! Por, padrejtësia që po u bën popujve, me të vërtetën e madhe, por me pafuqinë e tyre, ua ka errësuar sytë, ua ka ngurtësuar zemrat e i ka bërë më çnjerëzor! Është ky terr i syve që i bën ata "gladiatorë" para fëmijëve që në fakt duhet të jenë në shkollë, e në realitet ata struken në gërmadhat që flasin për terror.

Kjo vjen e parë dekadë pas dekadë si urrejtje që kanë ndaj islamit dhe përhapjes së tij masive, ndaj urtësisë që mbjell ndër popuj, duke i kushtuar rëndësi çdo fryme.

A ju kujtohet se para disa kohësh u shtrua një problem i madh mbi një specie në zhdukje? Këtu po zhduket një popull i tërë! Njerëz që vdesin dita ditës, lagje që s'pastrohen dita-ditës e askush nuk mendon për ta. Ndërkohë, që për një specie në zhdukje, mblidhen ekspertë, bëhen rezoluta, krijohet problem serioz si për ironi të asaj që një trup besimtari nuk vlen as a një specie!

Kjo është karta e të drejtave të njeriut? Kjo është demokracia dhe liria?

Kur bëhet fjalë për myslimanët, të gjithë ato harrojnë se çështja e Kudsit dhe çështja e Gazës nuk është çështje e arabëve apo e palestinezëve, por është çështje e të gjithë myslimanëve të botës!

Ne si besimtarë myslimanë kemi një mundësi për t'i ndihmuar ato vëllezër atje!

Mos t'i shpëtojë lutjes tonë lutja për vëllezërit në Palestinë dhe kudo.

Kudo në botë ka protesta për këtë çështje, ndërsa ne për tu solidarizuar me ta do të protestojmë para derës së Gjithëpushtetshmit e të Gjithëmë-shirshmit! Amin!



Kur e patën hebrenjtë shporrën prej aty të krishterët e parë, pastaj: Kur e patën të krishterët shporrën prej aty hebrenjtë, më pas

e morën myslimanët, të cilët i lejuan të tërë të jetojnë secili komunitet dhe besim,

pastaj ra në dorë të kryqëzatave që keqtrajtuuan hebrenjtë dhe myslimanët

pastaj e morën myslimanët, ku jetuan të tërë në harmoni;

pastaj Jeruzalemi bie në dorë të hebrenjve dhe që para 8-të dekadash e deri më sot janë keqtrajtuar barbarisht të tëra besimet.

Mos vallë bota po pret të bëhen 10-të dekada që të binden se në këtë tokë paqeje të vërtetë vendosin vetëm se ata që i pranojnë të tërë profetët?!

Vetëm myslimanët e kanë këtë mundësi dhe se për këtë ata kanë dhënë prova herët dhe vonë. A kanë veshë që dëgjojnë dhe mendje që logjikojnë?!

JERUZALEMI & PALESTINA

e vërteta e historisë së tyre

Mr. Ajni Sinani

Sipas të dhënave të sakta historike, Jeruzalemi është formuar rreth vitit 1800 para erës së re nga ana e Jebusitëve që përfaqësonin nëngrupin e Kananitëve. I pari që e ka ndërtuar qytetin ka qenë sundimtari i fuqishëm kananit që quhej Melchizedek "mbret i drejtë". Ai e quajti vendin Jerusalim. Ky vend, më herët quhej "Salem", që do të thotë "i plotë" apo "pa defekt". Kështu, Jerusalem do të thotë "qytet i përsosur" apo "qyteti i atij që është i përsosur, qyteti i paqes", arabisht El Kuds.

Qyteti, përveç periudhës prej shekullit të XV deri në shekullin e XIII para epokës sonë kur ka qenë i pushtuar prej faraonëve egjiptianë, ka mbetur nën sundimin e Kanaanitëve deri në vitin 1000 para erës së re, kur u pushtua nga mbreti i çifutëve Davidi (Davudi a.s.). Davidi e shpalli Jerusalemin qytetin kryesor të mbretërisë së Judës, kurse i biri i tij Solomoni (Sulejmani a.s.) ndërtoi aty tempullin e njohur të Solomonit. Pas vdekjes së Solomonit Judeja u bë shtet vasal, kurse në vitin 587 para erës së re u zhduk plotësisht nga babilonasit. Që nga viti 587 para erës së re pushteti hebraik u ndërpre. Në vitin 70 të erës sonë, perandori romak Titus e shkatërroi qytetin e Jerusalemit dhe e dogji Tempullin. Të dy kryengritjet e hebrenjve kundër okupatorit romak, njëra në vitin 70, e tjetra në vitin 135 të erës së re, u shuan. Pas shuarjes së kryengritjes së dytë, të cilën e udhëhoqi Bar Kobhi, Orjanosi i zhduku tërësisht të gjitha shenjat e qytetit, i vrau hebrenjtë dhe në Palestinë u ndërpre ekzistenca e bashkësisë hebraike.

Palestinezët kanë vazhduar të jenë në mënyrë të pandërprerë në Jerusalem, madje edhe në kohën e sundimit të mbretërve çifut mbi ta. Popullata palestineze nuk u dëbua nga qyteti nga babilonasit dhe romakët. Më vonë, ata pranuan krishterizmin, kurse më ardhjen e Islamit pjesë dërmuese e tyre pranuan Islamin. Pra, Jerusalem ka ekzistuar si qytet arab disa shekuj para ardhjes së hebrenjve në Palestinë, dhe ka vazhduar si i tillë edhe pas rënies së mbretërisë së Judesë, për më shumë se 19 shekuj.

Në vitin 638 të epokës së re, Jerusalemi është marrë nga halifi i dytë, Omeri (r.a.). Jerusalemi ka qenë pjesë e shtetit islamik, me përjashtim të 88 vjetëve kur u pushtua nga kryqtarët (1099-1187), deri në 9 dhjetor të vitit 1917 kur u pushtua nga forcat britanike. Gjatë luftës së parë arabo-izraelite (1948), Izraeli pushtoi pjesën e re të Jerusalemit, kurse Jordania pjesën e vjetër të tij. Kështu Jerusalemi vazhdoi të jetë i ndarë deri në vitin 1967, kur forcat izraelite e pushtuan gjithë qytetin.

Mirëpo, për shkak të migrimit të çifutëve përbërja e tij etnike filloi të ndryshojë. Jerusalemi me kalimin e kohës filloi të zgjerohet edhe jashtë mureve të tij. U ndërtuan lagje të reja nga ana e arabëve dhe e hebrenjve. Si rezultat i kësaj u formuan dy emra për qytetin, qyteti i vjetër: pjesa e rrethuar e Jerusalemit dhe qyteti i ri: lagjet arabe dhe hebraike të ndërtuara jashtë mureve të tij, që u pushtuan nga Izraeli më 1948.

Rreth tre të katërtat e tokës dhe të ndërtesave të Jerusalemit Perëndimor kanë qenë pronë e arabëve palestinezë, të cilët kanë përfaqësuar pjesën më të madhe të banorëve të tij deri në vitin 1948, kur u detyruan ta braktisnin qytetin në mënyrë masive.

Prandaj sipas arabëve dhe shumë studiuesve, agresioni izraelit ndaj Jerusalemit, si ndaj pjesës së re ashtu edhe ndaj pjesës së vjetër, paraqet uzurpim të territorit të tij, gjë që është e kundërligjshme dhe nuk paraqet kurrfarë baze për fitimin e sovranitetit hebraik mbi qytetin. Kjo ngase sipas të Drejtës Ndërkombëtare pushtimi i një territori ushtarakisht nuk paraqet bazë për përvetësimin e tij. Prandaj në disa rezoluta të Kombeve të Bashkuara, që kanë trajtuar çështjen e konfliktit arabo-izraelit dhe të agresionit izraelit mbi Jerusalem është proklamuar “mospranimi i fitimit të territoreve përmes luftës ose pushtimeve me luftë”.

Izraeli u formua sipas një vendimi të OKB-së që caktoi kufijtë e tij, të drejtat dhe obligimet e tij ndërkombëtare. Me

rastin e paraqitjes së kërkesës për pranim në Kombet e Bashkuara, Izraeli mori përsipër se do t'i respektonte rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Këshillit të Sigurimit të OKB, veçanërisht rezolutën 181 të vitit 1947, rezolutën 194 të vitit 1948, me të cilat u vërtetua parimi i statusit internacional të Jerusalemit.

SHBA-ja nuk është shprehur për ndonjë qëndrim të caktuar rreth Jerusalemit dhe janë angazhuar që statusi përfundimtar i Jerusalemit duhet të përcaktohet përmes bisedimeve. Ato nuk e kanë njohur bashkëngjitjen e Jerusalemit (Kudsit) Lindor Izraelit. Sipas SHBA-së duhet që palestinezëve të Jerusalemit Lindor t'u mundësohet të marrin pjesë në bisedimet rreth statusit përfundimtar. SHBA ka mbështetur të drejtën e palestinezëve për parashtrimin e çdo çështjeje, duke përfshirë këtu edhe çështjen e Jerusalemit Lindor në tryezën e veçantë të bisedimeve.

Qëndrim të ngjashëm ka mbajtur edhe qeveria britanike, e cila pas aneksimit të Jerusalemit nga ana e Izraelit më 27 nëntor 1967 ka deklaruar se “përderisa në vitin 1949 kishte pranuar "de facto" pushtetin e Izraelit dhe të Jordanisë në pjesën e vjetër dhe të re të Jerusalemit, de jure nuk e kishte pranuar sovranitetin e tyre ndaj cilësdo pjesë të qytetit, që sipas rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së nr. 303 (IV) të 9 dhjetorit 1949, kishte fituar statusin internacional. Kur më 30 korrik të vitit 1980, Kneseti Izraelit e shpalli zyrtarisht qytetin e bashkuar si Kryeqytet të përjetshëm të shtetit të Izraelit, bashkësia ndërkombëtare nuk e njohu një gjë të tillë. Mu për këtë, Shtetet e Bashkuara kanë refuzuar ta vendosin ambasadën e tyre në Jerusalem duke theksuar se kjo do të ishte “në kundërshtim me natyrën internacionale të Jerusalemit”.

Pas pushtimit të Jerusalemit, sionistët shkatërruan qendrën El Magaribah, përballë murit perëndimor të xhamisë “El Burak”. Ky mur, që përbëhet nga 135 vendbanime dhe 2 xhami, njihet nga

çifutët si muri i vajtimit. Ata e shndërruan atë në një territor të hapur për praktikimin e ritualeve të tyre çifute. Në përpjekjet e tyre të vazhdueshme për të gjetur mbetjet arkeologjike të tempullit, që ata pretendojnë të jetë “tempulli i Solomonit (Sulejmanit)”, çifutët kanë ndërmarrë gërmime intensive në pjesën jugore dhe perëndimore të Jerusalemit. Ata kanë ndërmarrë gërmime të shumta dhe kanë ndërtuar tunele poshtë xhamisë El Aksa, ku kanë përdorur substanca kimike për të shkatërruar shkëmbinj të poshtë saj.

Kërkimet, nga ana e çifutëve, vazhdojnë edhe sot e kësaj dite. Kjo e ka alarmuar popullatën palestineze dhe besimtarët muslimanë në shumë pjesë të botës. Këto veprime e kanë rrezikuar xhaminë e shenjtë me shembje, prandaj qeveria turke ka dërguar vëzhguesit e saj për të përcjellë gërmimet poshtë xhamisë El Aksa.

Jerusalemi tek myslimanët, të krishterët dhe çifutët

Jerusalemi është me rëndësi për çifutët për shkak të murit të vajtimit dhe Tempullit të Solomonit (Sulejmanit), sikurse besojnë ata, si dhe për të krishterët sepse në të gjendet “varri” i Jezusit (Isait) sipas bindjes së tyre. Jerusalemi është vendi i tretë për nga shenjtëria në botën islame. Ai është kibla e parë e myslimanëve dhe në të ndodhet Xhamia El Aksa. Ajo është xhamia e dytë që Ibrahim i ndërtoi 40 vjet pas xhamisë së Kabes.

Që nga viti 1967, kur Izraeli pushtoi edhe Jerusalemin Lindor, KB-ja dhe Këshilli i Sigurimit miratuan një sërë rezolutash që nuk pranonin aneksimin izraelit të Jerusalemit Lindor dhe shfuqizuan çdo masë të ndërmarrë fizike apo administrative për të ndryshuar statusin e qytetit. Mirëpo, Izraeli, sikurse shprehet Naom Chomsky, është shteti që i ka refuzuar më së shumti rezolutat e KB-së. Izraeli përdor vazhdimisht një retorikë të shenjtë gjatë diskutimit për pandashmërinë e Jerusalemit. Izraeli e konsideron Jerusalemin si selinë e vet

unike dhe të përhershme në sovranitetin izraelit. Prandaj tenton me këmbëngulje që ta largojë çështjen e Jerusalemit nga bisedimet në lidhje me zgjidhjen e problemit palestinez dhe refuzon pjesëmarrjen e banorëve të Jerusalemit në çfarëdo funksioni të administratës autonome palestineze. Ndërkaq, sipas qëndrimit palestinez, Jerusalemi është pjesë e Bregut Perëndimor, prandaj për Jerusalemin vlejnjë të gjitha ato ligje që vlejnjë për çdo pjesë të territoreve të pushtuara.

Një Jerusalemi, në historinë arabe dhe me tolerancë, ku Hebraizmi, Krishterizmi dhe Islami mund të jetojnë në harmoni dhe liri të plotë, do të ishte një zgjidhje ideale për këtë qytet. Në Jerusalemi, që është qytet i paqes dhe që gëzon respekt nga të tria fetë, ka mbizotëruar paqja që nga çlirimi i Jerusalemit nga myslimanët. Mirëpo, Izraeli nuk dëshiron t'i pranojë faktet historike dhe pohon se ka të “drejtë të shenjtë” mbi qytetin dhe se popullsia e tanishme e tij ka prejardhje prej hebrenjve biblikë. Izraelitët, vazhdimisht, janë munduar ta mohojnë karakterin historik të Jerusalemit si qendër e tre feve botërore.

Okupimi i Jerusalemit paraqet shkelje të vendimeve të OKB-së dhe cenim të deklaratës së Balfourit, ku është thënë se: “nuk do të bëhet asgjë që mund të cenojë të drejtat civile dhe fetare të komuniteteve ekzistuese joçifute në Palestinë”. Izraeli, nëpërmjet mjeteve ushtarako-politike, e ka ndryshuar strukturën demografike të qytetit në dëm të popullatës arabe. Duke theksuar se e drejta e çifutëve për Jerusalemin është më e fuqishme sesa e muslimanëve dhe e krishterëve, lëvizja sioniste ka deklaruar se pa Jerusalemin, si qendër e hebraizmit, nuk mund të ekzistojë as Izraeli si shtet. Ish kryeministri izraelit, Ben Gurion, është shprehur: “Izraeli nuk ka kuptim pa Jerusalemin dhe vetë Jerusalemi nuk ka kuptim pa tempullin (e Solomonit)”.

NJË DITË NË TEL AVIV

Nga: J .Bakiu

Në botën ku shkenca dhe dija ka përparuar, ku liria, të drejtat dhe demokracia janë themelet e shoqërive në ngritje, në këto shekuj ku thuren dhe themelohen konventa të drejtash të barabarta njerëzish të botëve të ndryshme, ne përballemi me monstruozeitetin e pashoq, rast të cilin do jua tregoj siç e përjetova para pak ditësh:

Duke jetuar edhe unë në mes të gjithë këtyre të "mirave" vendosa të shoh përtej mendimit: A është e vërtetë ajo se shumë mendje të ndritura thonë se jetojmë në një kohë ku hipokrizia i kalon majat e maleve, padrejtësia të vret sikur malet të bien mbi supe?!

E sikur të ishte vetëm kaq këta thonë se sot festohet pavarësia e fitorja nga tirania e shkatërrimi. Por, mes shumë çudive kthehet në tirani e shkatërim gëzimi mbi padrejtësinë e tjetrit, e tirania e moderuar në emrin e kujdesit "të tepruar".

Mora një rrugë për të bërë, jo atë të emigrimit për një jetë më të mirë, plagë kjo për shumë popuj por, një rrugë, një udhëtim për të parë nga afër vende historike, për të parë diçka më shumë, ëndrrën e përsëritshme. Udhëtim në një vend të shenjtë, "Kuds-in". Kudsi, toka e premtuar e Musait, djepi e propagandës së Isait, vendi i dashur për shumë profetë, të cilët jetuan në monoteizëm dhe sakrifikuan çdo gjë.

I rregullt me të gjitha standartet që i duhen një qytetari turist, më thonë: - "Më falni, ju duhet të prisni që të vërtetojmë se kujt feje i përket mjekra juaj"! Kjo ishte mikpritja që në përballje të parë me disa zonja, të cilat më pyetën sërish - Ku do të falesh? Ke ardhur për turizëm?

I qartë dhe i qetë përgjigjem: - Aty, në çdo vend ku të më zërë koha e "faljes".

Habibi - më thotë njëra nga zonjat: - Si? Nuk do falesh në Kuds? Kur'ani ka folur shumë për të!

Me këto fjalë ajo sikur donte "të më këshillonte që duhet të jem më afër fesë".

Kjo ishte arsyeja që unë duhet të rrija dy orë i brengosur e të bëj sikur nuk kam kuptuar.

Megjithatë vërtetova atë që kisha lexuar: Duroj edhe nëse nuk jam i aftë ta peshoj a duhet duruar...?!

Kjo ishte "panorama", që përjetova në momentet e para të zbritjes sime në tokën e gllabëruar, nga ata të cilët vendosën rregulla tirani në këtë botë.

Këta që dikur pretenduan se ishin "viktimë" e shumëkush i besoi, sot janë kriminelë, e për çudi, luajnë aq shtirshëm rolin e viktimës se akoma i besojnë si "viktima"

A e dini përse?

Sepse ata e dinë të vërtetën dhe e refuzuan ndër shekuj siç na ka lajmëruar Kur'ani i madhëruar: "Ata e njohin atë (profetin e fundit, Muhamedin) siç njohin fëmijët e tyre..."

Para se gjumi të më mbërthejë, e fshijshtratin tim duke thënë: Me emrin e Zotit" duke e shoqëruar me lutjet e Kur'anit të cilat i kam si mburojë të padukshme nga djalli i mallkuar.

Ndoshta vërtet isha i singertë në këto lutje për t'u qetësuar më tej nga kjo ditë e lodhshme.

E në këtë gjendje m'u kujtua një nga thëniet e urta profetike. Ishte profeti i fundit Muhamedi, i cili tha:

"Tre njerëz nga Beni Israilët, Zoti deshi t'i sprovtojë. Njëri prej tyre ishte me sëmundje lëkure, i dyti qeros, kurse i treti i verbër.

All-llahu ua dërgoi një engjëll, i cili së pari i erdhi të zgjebosurit dhe i tha: "Ç'kishe dëshiruar më së shumti?" Tha: "Më së shumti kisha dëshiruar të kem ngjyrë dhe lëkurë të mirë e të çlirohem nga kjo për shkak të së cilës më urrejnë njerëzit". Engjëlli e fërkoj me dorë dhe prej tij ranë krejt zgjebjet dhe e fitoi ngjyrën e mirë (të trupit). (Pastaj engjëlli)

Tha: "Cilën pasuri dëshiron më së shumti?" Tha: "Devetë - ose lopët", ai ia jep një deve barsur dhe i thotë: "All-llahu të bekoftë me të!" Pastaj shkoi te qerosi dhe i tha: "Çfarë do dëshiroje më së shumti?" (Qerosi) Tha: "Flokë të bukura dhe të largohet prej meje ajo prej së cilës njerëzit neveriten nga unë." Engjëlli e fërkon dhe ai shërohet e i jipen flokë të bukur. (Pastaj engjëlli) Tha: "Cilën pasuri dëshiron më së shumti?" Tha: "Lopët". Engjëlli i dha një lopë të mbarsur dhe i tha: Allahu të bekoftë me të!

Kur ishte rradha e të verbërit, engjëlli i tha: Çfarë do dëshiroje më së shumti?" (I verbëri) Tha: "Të ma kthejë Zoti të pamurit, që t'i shoh njerëzit". Engjëlli e fërkon dhe Zoti ia kthen të pamurit. (Engjëlli) Tha: "Cilën pasuri e dëshiron më së shumti?" (I verbëri) Tha: "Dhentë!" Engjëlli ia jep një dele që lind. Te të tre pasuria u shtua e u rrit kështu që njëri (i zgjebosuri) e bëri një luginë me deve, i dyti e bëri një luginë me lopë dhe i treti (i verbëri) e bëri një luginë me dele. Pas kësaj engjëlli i vjen të zgjebosurit në formën

dhe pamjen e tij të mëparshme e i thotë: "Unë jam një njeri i mjerë, më janë këputur lidhjet në këtë udhëtim timin, andaj sot askush nuk mund të më ndihmojë përveç All-llahut, e pastaj ti, andaj po të lutem në emrin e Atij që të ka dhënë ngjyrë dhe lëkurë aq të bukur dhe që të ka dhënë kaq deve, të më japësh një deve që të mund ta vazhdoj rrugën". (Ish- i zgjebosuri, tani i pasur). Tha: "Jo, unë kam shumë detyrime (borxhe). (Engjëlli) i tha: "Sikur po të njoh unë ty, a mos ke qenë një i zgjebosur nga i cili neveriteshin njerëzit, një i varfër të cilin Zoti e ka pasuruar!" Tha: "Unë këtë pasuri e kam trashëguar nga të parët e mëdhenj".

Engjëlli i tha: "Nëse po gënjen, le të të kthejë Zoti në atë gjendje në të cilën ke qenë".

Më pas engjëlli i shkon ish-qerosit e i thotë ashtu siç i tha të parit, por edhe ky i përgjigjet njësoj.

Engjëlli i tha: "Nëse po gënjen, le të të kthejë Zoti në atë gjendje në të cilën ke qenë".

Më pas engjëlli i shkon ish të verbërit e i thotë: "Unë jam një njeri i mjerë, më janë këputur lidhjet në këtë udhëtim timin, andaj sot askush nuk mund të më ndihmojë përveç All-llahut, e pastaj ti, andaj po të lutem në emrin e Atij që të ka dhënë shikimin, më jep një dele që të vazhdoj rrugën!" Ish i verbëri tha: "Vërtet isha i verbër, por Zoti ma ktheu shikimin. Merr vëlla çfarë të duash dhe lër çfarë të duash!"

- "Mbaje të gjithë pasurinë, ju vetëm, keni qenë të sprovuar. All-llahu është i kënaqur me ty, kurse është i hidhëruar me dy shokët e tu".

Kështu jehudët janë dhe do jenë mohues e mosmirënjohës të të mirave që ju dhuroi Zoti.



ndalima Lotim...

Padrejaësia është e hershme në historinë njerëzore. Mund të themi që ajo ka nisur që me njerëzit e parë në tokë, me bijtë e babait të njerëzimit Ademit dhe Havasë. Historia në çdo kohë ka regjistruar padrejtësi nga më të mëdhatë, të llojeve të ndryshme! Nga padrejtësitë më të dhimbshme mes njerëzve është vrasja e fëmijëve, dhunimi i grave. Në çdo kohë kanë ekzistuar njerëz që iu është fikur drita e mëshirës dhe çdo gjë para syve të tyre duket errësirë. Dora e tyre nuk dridhet dhe arroganca e tyre i kalon kufinjte e dashurisë njerëzore. Njëri prej tyre ishte faraoni i kohës së Musait, e të tilla histori shfaqen në kohë të ndryshme, ku zënë e dalin kriminelë e terroristë si ai. Ato shfaqen dhunshëm e nga ana tjetër kemi pishtarët e mëshirës që i mbrojnë nderet dhe jetët e këtyre siç ishte Musai.

Është njerëzore, po ti kthehemi këtyre historive për të marrë mësim dhe për të zgjedhur rrugën e duhur se ku duhet të ecim.

Në kohën kur lufta e dytë botërore kishte ndezur flakët e padrejtësisë u rishfaqën shumë padrejtësi dhe histori mizore, ku Hitleri ishte protagonist kryesor i krimit dhe terrorit ndaj popullit hebrej. Dhe sigurisht që dënohej çdokush që i mbronte ata. Por, pati shumë prej njerëzve që mbartën në zemrat e tyre dritë mëshire. Njëra prej tyre ishte nënë Besa, një nënë

ndalima

shqiptare, nënë fisnike, një nënë me zemër të madhe, që sakrifikoje çdo gjë në emër të bujarisë, mëshirës e humanizmit. Një zemër që kundërshtonte çdo padrejtësi e terror. Zoti e mëshiroftë nënë Besën, e cila fshehu dhe mbrojti, ushqeui dhe dhuroi, mëshirën e saj. Ajo sot vlerësohet shumë nga populli hebrej. Asaj i kanë dhuruar një vend, në një nga galeritë e mëdha të Muzeut të Holokaustit. Nënë Besa, qëndron aty e heshtur, në një fotografi të madhe, e veshur shumë fisnike me një napë të bardhë e me një fytyrë bujare. Ajo mban në duart e saj një libër që e ka emrin: "Kur'an".

Ajo kërkon të thotë se unë jam një nënë që jam ushqyer me fjalët e Zotit, i cili na ka mësuar se kush shpëton një jetë është sikur ka shpëtuar gjithë njerëzimin. Nënë Besa ka kuptuar misionin e profetit Musa, të profetit Isa dhe padyshim misionin e profetit të fundit Muhamed, i cili ka ardhur si mëshirë për njerëzimin.

Nënë Besa pret me mijëra turistë nga mbarë bota, të cilët mahniten dhe çuditen për zemrën e saj.

Kjo nënë vizitohet nga shumë e për çudi jo nga bijtë e saj jo. Jo nga ata që besojnë në Kur'an, pasi ata janë të privuar të shohin këtë nder dhe rrespekt që i bëjnë nënës së tyre.

Dhe kur ndonjë prej këtyre bijve dëshiron ta vizitojë, i duhet të kalojë në shumë peripeci për të parë këtë foto të madhe në një nga galeritë e Muzeut.

Duke qëndruar para kësaj fotografie të madhe, para kësaj gruaje fisnike, çdokush do të dëshironte të bisedonte me të, e t'i tregonte për padrejtësitë e kohëve moderne, t'i tregonte se ata hebrej që të kanë ngritur këtë pedestal, po bëjnë padrejtësitë e rradhës ndaj fëmijëve e grave palestineze. Këta hebrej të pangopur që nuk u mjaftoi gllabërimi që i bënë tokës së Palestinës, duan të vazhdojnë kënaqësitë e tyre tiranike mbi fëmijët e gratë palestineze.

Nënë Besa, do të ishte e para që do t'u dilte në ballë këtyre, ajo që mbajti në prehrin e saj për t'i mbrojtur nga padrejtësia që përdodh në Gaza. Fëmijë e gra që kërkojnë të drejtat e tyre, nëna, bijë e fëmijë, tek thonë "ndalma lotin..."

Për çdo nënë që ka zemër të madhe, për çdo nënë në botë që ka zemër "nëne"... se çdo zemër nëne duhet të jetë "e madhe".

nga J. Bakiu



Ndalma lotin ti o vëlla,
ndalma lotin ti o motër,
edhe gjakun përmbi trup,
deri kur a ka një fund?

Ku janë lodrat që të luaj,
ku janë librat të mësoj,
ku është parku të pushoj,
a ka dritë ku mund të shikoj

Të shpërndarë nëpër botë
të shkatërruar përmbi tokë
kudo zjarr e anë e mbanë
kam humbur nënën e babanë

të lutem ty e zeza botë
ma dëgjo këtë rënkim
që therret e qan ndër lot
dëgjoje profetin tim

ai thërriti në drejtësi
mëshirë e plot udhëzim
Zoti juaj edhe i imi
na udhëzofte në çdo drejtim